Kriza e çmimeve të inputeve bujqësore na thërret për një "patriotizëm të gjelbër"

Faqe 7

BERZH dhe Banka Intesa SanPaolo mbështesin turizmin dhe agrobiznesin

Faqe 6

Irjana Gjana: Standardi lokal shqiptar (localg.a.p) më shumë siguri për konsumatorin dhe shitje të garantuar

Faqe 3

KËSHILLI I AGROBIZNESIT SHQIPTAR

AGROBIZNESI

BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR
Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

FED invest
Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh, Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.
Tel: +355 4 2 251 910 /911
Email: info@fedinvest.al
kontakt@fedinvest.al
www.fedinvest.al

15-ditëshi i parë i muajit mars 2022

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 433
Çmimi 125 lekë

E përdyjavshme e pavarur

DYFISHOHET SIPËRFQJA E CERTIFIKUAR ME GLOBAL G.A.P.

VAZHDON ME SUKSES PROCESI I CERTIFIKIMIT NË GRUP PËRMES SHOQËRIVE TË BASHKËPUNIMIT BUJQËSOR (SHBB), PËR PAJISJEN E TYRE ME CERTIFIKATËN E CILËSISË GLOBAL G.A.P.

Kreu i Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar (KASH), Agim Rrapaj, shprehet se Konstituimi i Grupit Kombëtar Teknik të Punës për Standardin GlobalG.A.P. në Shqipëri ishte një tjetër arritje e realizuar me mbështetjen e RisiAlbania

RISI ALBANIA NJË PROJEKT I AGJENCISË ZVICERANE SDC

Marketingu dixhital dhe tregtia elektronike janë investimet prioritare për të ardhmen e agroindustrisë

Qeveria Zvicerane kontribut për zhvillimin rural në Shqipëri

RisiAlbania Partner for Growth

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Faqe 2

GRATË NË SIPËRMARRJE

Në ditën ndërkombëtare të grave apelohet: "Pjesëmarrja e tyre në tregun e punës nxit rritjen ekonomike"

Faqe 2

PROFIL

Petro Laboviti, agronomi i talentuar i dy sistemeve

Nga: Koço Mosko, Agronom i Mbrojtjes së Bimëve
Boston, MA - SHBA

Faqe 10

KËNDI I EKSPERTIT

- *Teknika e rritjes dhe e mbarështimit të zogjve brojler, dhe përdorimi i racionit ushqimor me ushqime të peletuara* Fq.11
- *Informacion për fermerët që kultiojnë bimë aromatike medicinale (bam), mars 2022* Fq.12
- *UNDROP - Deklarata e OKB për të drejtat e fshatarëve dhe ...* Fq.14

Hapet tregu i grurit dhe i misrit, Shqipëri-Serbi rikonfirmojnë marrëveshjen "Ballkani i Hapur"

Faqe 5

AGROTURIZËM

Thirrja për aplikime e hapur për idetë e turizmit të qëndrueshëm

Faqe 2

RISI ALBANIA

Marketingu dixhital dhe tregtia elektronike janë investimet prioritare për të ardhmen e agroindustrisë

Një sondazh i realizuar së fundmi mbi përdorimin dhe rëndësinë e marketingut dixhital në sektorin e agroindustrisë, tregoi se në vendin tonë, ky tregues është ende në nivele të ulëta.

Sektori i Agrobiznesit

Në këtë sondazh nga sektori i Agrobiznesit, 41% janë nga pika grumbullimi/tregtie, 31% e të anketuarve janë nga bujqësia/blegtoria, 13% nga agroturizmi dhe 15% e të anketuarve janë nga kompanitë e shpërndarjes. Kompanitë e këtij sektori kanë më pak staf të dedikuar për IT dhe marketingun dixhital. Investimet në fushën e marketingut dixhital apo pagesave dixhitale janë mjaft të ulëta, një fakt i mbështetur nga të dhënat e sondazhit që thonë se vetëm 4% e kompanive kanë një strategji dixhitale për të ardhmen. Pengesa kryesore për përfitimet e dixhitalizimit nuk është vetëm buxheti i kufizuar i kompanive, por edhe mungesa e aftësive për të përdorur teknologjitë dixhitale.

Kryesisht ekipi menaxhues nuk ka shumë informacion dhe vizion të qartë për këtë çështje. Marketingu dixhital dhe tregtia elektronike janë investimet prioritare për të ardhmen e këtij sektori. Vetëm 12% e kompanive planifikojnë të rrisin investimet në dixhitalizimin e kompanive deri në 10% të të ardhurave të tyre

KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET

Nga analiza e të dhënave rezulton se për të gjashtë sektorët teknologjitë e informacionit dhe komunikimit kanë një rol të veçantë në zhvillimin dhe përmirësimin e proceseve të biznesit. Të gjitha kompanitë për qëllime të komunikimit masiv dhe informacionit përdorin email, telefona, faqe interneti dhe rrjete të mediave sociale. Sistemet dixhitale për të cilat kompanitë investojnë ose ofrojnë më shumë përbëhen nga marketingu dixhital, tregtia elektronike dhe pagesat dixhitale dhe investimi më i ulët i referohet Sistemeve ERP. Softuerët që kompanitë përdorin ose ofrojnë më shumë janë kryesisht në IT Helpdesk, Financë / Kontabilitet dhe pagesa dixhitale, ndërsa softueri më pak i përdorur i përket Menaxhimit të Zinxhirit të Furnizimit.

Të dhënat tregojnë se sektorët që lidhen me kërkesën më të dixhitalizuar janë Sektori Financiar, Sektori i BPO-ve dhe Sektori i Prodhimit dhe më pak të dixhitalizuar janë sektorët e hotelerisë dhe turizmit dhe agrobiznesit. Kontraktorët e brendshëm dhe të jashtëm për një pjesë të madhe të zgjidhjeve të TIK përdoren në të gjithë sektorët. Të dhënat tregojnë se zgjidhjet e brendshme kryesisht kanë të bëjnë me mirëmbajtjen dhe zhvillimin e faqeve të internetit, si dhe me zhvillimin dhe mbështetjen e softuerit.

Kontraktorët ndërkombëtarë janë punësuar kryesisht për të ofruar zgjidhje dhe mbështetje për sigurinë e TIK-ut dhe mbrojtjen e të dhënave. Për sektorin e TIK, e-commerce, Menaxhimi Financiar dhe sistemet ERP janë zgjidhjet dixhitale më të ofruara për të cilat të gjitha kompanitë kanë staf të kualifikuar për shërbimet e ofruara dhe janë vazhdimisht në kërkim të stafeve të reja. Zhvillimet rregullatore si: legjislacioni, rregulloret për mbrojtjen e të dhënave, transaksionet dixhitale, tregtia dixhitale, identifikimi dixhital mund të stimulojnë ofertën dhe kërkesën për zgjidhjet dixhitale të kompanive. Barrierat kryesore që pengojnë kompanitë të përfitojnë nga tendencat dixhitale konsistojnë në buxhetin e kufizuar, mungesën e aftësive teknike dhe mungesën e strategjisë dixhitale. Investimet kryesore të kompanive për vitin e ardhshëm janë kryesisht në fushat e Marketingut Dixhital, e-commerce, analizës së të dhënave apo modeleve dixhitale të biznesit. Këto investime pritet të sjellin rritje të të ardhurave, të rrisin imazhin e markës së kompanive dhe vendimmarrjen bazuar në analizën e të dhënave.

Sektori i hotelerisë dhe turizmit dhe ai i agrobiznesit demonstrojnë një potencial të lartë për zbatimin dhe adoptimin e shërbimeve dixhitale, lidhur me prioritetet si dhe me dinamikën dhe zhvillimet ekonomike në këta sektorë. Rekomandohet që të gjithë sektorët të rrisin nivelin e dixhitalizimit dhe përdorimit të TIK-ut në proceset e tyre të punës apo menaxhimin e të dhënave.

Sektorët që janë më pak të dixhitalizuar rezultojnë në Agrobiznes dhe Mikpritje dhe Turizëm duke pasur parasysh se nuk kanë një strategji dixhitale të miratuar. Duhet të zhvillohet niveli menaxherial i kompanive në të gjithë sektorët, duke rritur kapacitetet e ekipeve të tyre për të zhvilluar projekte dixhitale duke rritur buxhetin në këtë fushë. Legjislacioni, rregulloret dhe aktet kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në dixhitalizimin e sektorëve ekonomikë duke u fokusuar kryesisht në mbrojtjen e të dhënave, transaksionet dixhitale, mbrojtjen e konsumatorëve dhe tregtinë elektronike.

Në ditën ndërkombëtare të grave apelohet: "Pjesëmarrja e tyre në tregun e punës nxit rritjen ekonomike"

Në Evropë dhe Azinë Qendrore, gratë janë një burim madhor talenti dhe produktiviteti. Pjesëmarrja e tyre në tregun e punës nxit rritjen ekonomike. Është e nevojshme të shpejtohen veprimet drejt një barazie gjinore dhe përfshirjes së grave si agjentë të ndryshimit për një zhvillim të paqtë, të qendrueshëm, të gjelbër e gjithëpërfshirës.

Projekti RisiAlbania në 8 mars, në Ditën Ndërkombëtare të Gruas, sjell në vëmendje dhe apelon se tema botërore është 'Barazia gjinore sot për një të nesërme të qëndrueshme!'

Risi dhe partnerët aplikojnë parimet e barazisë gjinore në përpjekjet e përbashkëta drejt rezultateve të qëndrueshme në tregun e punës.

Përgjatë këtyre 8 viteve, janë punësuar mbi 2000 gra dhe vajza të reja, ndërkohë që vijojmë punën për perspektiva të tjera të punësimit të të rejave dhe të rinjve në Shqipëri.

Iniciativa për përmbajtje interaktive mbi barazinë në tregun e punës dhe historitë frymëzuese janë shembuj konkret për nxitjen e grave në sipërmarrje.

Gladiola Dona është themeleuese e Hospitality and Tourisem Academy. Ajo tregon se dëshira për të hyrë në tregun e hoteleri turizmit, lindi përpara shumë vitesh kur studionte hoteleri turizën në Austri, aty ku dhe mori eksperiencën e një sholle ideale ku ndërthurej teoria me praktikën. "Atje pas shkollës kreva dhe një praktikë në hotelet më të mira të Austrtisë dhe vendosa të kthehem në Shqipëri por tregu këtu nuk më ofron atë imazh që më ishe ngulitur në mendje kur isha në Austri", tregon Dona. Kështu që për shumë vite nuk u more me këtë degë por dëshira për të dhënë në këtë fushë mbeti një ëndër e pashuar që ishte pasioni. Kështu në 2015 hapëm dyert e Akademisë së Turizmit dhe prisnim me padurim se kush do të hynte në derën tonë dhe aty filloi sfida, sepse tregu ishte i paformuar dhe me shumë vështirësi por për fatin tim të mirë ishte RisiAlbania e cila më ndihmoi me 30 të papunët e parë të cilët ne i trajnuam dhe ata u punësuan dhe u bënë dëshmiaratët tanë të treg, që atë se çfarë ne ofrojmë në treg ka vlerë. 5 vite në treg ka nxjerrë hotelierë, menaxherë, banakierë profesionistë shumë të suksesshmen dhe ajo që ne na bën krenarë është pikërisht performaca e këtyre njerëzve. Janë pikërisht këto njerëz që bëjnë diferencën në treg të cilët kanë dalë ng akademia jonë.

Natyrisht që është edhe emocion, modeli që kemi krijuar në akademinë tonë bashkë me pasionin për turizmin, për hotelerinë, bashkërisht rritemi, analizojmë arritjet tona dhe bëhemi partnerë të pandarë për të arritur dhe bërë më mirë hoteleri turizmin në Shqipëri

Një shembull tjetër është edhe rasti i artizaneve të reja. Zonat e Korçes dhe të Shkodrës pas finalizimit të fazës së parë të projektit për qarkullimin dhe riciklimin bazuar te bimët medicinale aromatike dhe produkteve të tjera po i kthejnë në përdorim shtëpiak. Vera Ndoj është artizane e cila prej vitesh merret me përpunimin dhe realizimin e sapunëve dhe detergjentëve të ndryshëm. Sipas Verës, biznesi familjar që ajo ka ngritur, ka për synim që të jetë prezent në tregun vendas por edhe të huaj.

Vaji i fast foodeve sipas artizanes Vera Ndoj, është një tjetër element i cili përdoret për realizimin e detergjenteve të ndryshëm. Vaji i cili përdoret fillimisht reciklohet dhe më pas bëhet së bashku me bimë medicionale ku realizohen detergjentë.

Artizanet shprehen se ngritja e një tregu për shitjen e këtyre produkteve do ishte një hap para për biznesin e vogël. Sipas Verës, këto produkte janë bio shqiptare të cilat kanë një përkushtim dhe kujdes deri në realizimin e produkteve.

224 vajza të reja kanë arritur të punësohen apo të krijojnë biznesin e tyre pasi kanë ndjekur kurse nga ofrues të trajnimeve jo-formale me mbështetjen e RisiAlbania.

Thirrja për aplikime e hapur për idetë e turizmit të qëndrueshëm

Një thirrje për ide që promovojnë turizmin e qëndrueshëm në Shqipëri që krijon mundësi pune është hapur tashmë nga RisiAlbania. Qëllimi i projektit është të ofrojë opsione alternative për turizmin bregdetar sezonal dhe të rrisë mundësitë e punësimit për personat e moshës 15-29 vjeç, veçanërisht për ata që jetojnë në zona të thella. Kështu, thirrja synon rritjen e kapaciteteve të operatorëve turistikë vendas për të promovuar ofertat e qëndrueshme turistike dhe për t'i ndihmuar ata të aksesojnë tregje të reja turistike. Bazuar në shpalljen e thirrjes, projekti do të mbështesë propozime që promovojnë produkte turistike që shtrihen përtej sezonit veror të fokusuar në modelet e turizmit të qëndrueshëm në produktet ekzistuese ose të reja.

Më tej, shpallja e thirrjes rendit kriteret kryesore për përzgjedhjen e propozimeve.

Ideja/shërbimi/turet duhet të krijojnë vende të reja pune për të rinjtë.

Shërbimet apo produktet e reja krijohen dhe zbatohen në bashkëpunim me komunitetet dhe bizneset lokale.

Udhëtimet zhvillohen gjatë sezonit të dimrit dhe ose sezoneve të ndërmjetme ose zgjasin kohëzgjatjen e qëndrimit gjatë sezonit të pikut.

Turneu duhet të përfshijë zonat rurale. Të paktën 30 për qind e nje nate qëndrimi në turne duhet të jetë në zonat rurale dhe të largëta.

Aplikimet e paraqitura në këtë thirrje duhet të jenë të qëndrueshme ekonomikisht, mjedisore dhe sociale.

Kriteret për aplikantët:

Ata duhet të jenë agjenci turistike të regjistruara me një rekord të dëshmuar të shitjeve dhe organizimit të paketave turistike.

Të ketë lidhje me agjenci ndërkombëtare

Të kenë mjetet e tyre të marketingut dixhital si faqet e internetit dhe mediat sociale.

Për më shumë detaje mbi përmbajtjen e propozimit dhe dorëzimit të aplikimit lexoni këtë dokument.

Thirrje për ide për të promovuar turizmin e qëndrueshëm në Shqipëri që çon në krijimin e vendeve të punës

1. Hyrje

Projekti RisiAlbania mbështetet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), në partneritet me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë së Shqipërisë dhe zbatohet nga një konsorcium i përbërë nga HELVETAS Swiss Intercooperation dhe Partners Albania për Ndryshim dhe Zhvillim. Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të kontribuojë në rritjen e mundësive të punësimit për të rinjtë dhe të rejat (15-29 vjeç) në Shqipëri. Ky synim do të arrihet përmes:

(i) Nxitjes së rritjes dhe krijimit të vendeve të punës nga sektori privat në tre nënsektorë të përzgjedhur agrobiznes, turizëm dhe TIK,

(ii) Përmirësimi i aksesit në mundësitë e punësimit dhe informacionet dhe shërbimet për tregun e punës (ndërmjetësimi), dhe

(iii) Përmirësimi i aftësive të të rinjve duke përmirësuar ofertën e ofruesve privatë të trajnimit në tre sektorët e përzgjedhur (furnizimi i punës).

Në turizëm, sezonaliteti dhe përqendrimi në zonat bregdetare janë ndër simptomat më të spikatura të një mosfunksionimi aktual të tregut në sektorin e turizmit shqiptar: ka pak produkte që ofrojnë përvoja alternative për turistët dhe kapacitetet e bizneseve rurale për t'u përfshirë në aktivitete turistike janë të dobëta. Megjithatë, turistët ndërkombëtarë kanë kërkesa për udhëtime që tejkalojnë shumë këtë prirje të lartë sezonale: ka potencial për të zgjeruar ofertën turistike të Shqipërisë për të mbuluar muaj të tjerë.

Për më tepër, Shqipëria ka një potencial të madh për të hyrë në tregun e turizmit të qëndrueshëm dhe për t'u ofruar turistëve përjetime kulturash të reja, për t'u takuar dhe për t'u angazhuar me njerëzit vendas dhe për të jetuar përvoja autentike. Prandaj, paketat e reja të turizmit të qëndrueshëm kanë ndikim gjithëpërfshirës në komunitetet urbane dhe rurale.

Në Fazën 2, RisiAlbania mbështeti operatorët turistikë vendas për të zhvilluar paketa të qëndrueshme turistike që përfshijnë shumë zona rurale dhe ofrojnë mundësi punësimi për të rinjtë.

(Vijon në faqen 7)

STAFI I GAZETES

Kryetar i Bordit të Gazetës: Agim Rrapaj; **Bordi Drejtues: Zana Konini, Edmond Gjata, Shkëlqim Agolli, Ago Nezha, Enida Shena,**
Design & Layout: Elvira Çako Çeku; Asistente: Rozi Martini; Adresa: Rr."Mine Peza", P. 87/3, Hyrja 2, Kati 1, **Tel./ Fax**: ++ 355 4 2229445:
Web site: www.kashalbania.org E-mail: infokash@yahoo.com Llog. Bank.: TIRANA. BANK: AL09206110040000100301826100; INTESA: AL75208110080000001023231803

GLOBAL G.A.P.

DYFISHOHET SIPËRFQJA E CERTIFIKUAR ME GLOBAL G.A.P.

VAZHDON ME SUKSES PROCESI I CERTIFIKIMIT NË GRUP PËRMES SHOQËRIVE TË BASHKËPUNIMIT BUJQËSOR (SHBB), PËR PAJISJEN E TYRE ME CERTIFIKATËN E CILËSISË GLOBAL G.A.P.

Kreu i Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar (KASH), Agim Rrapaj, shprehet se Konstituimi i Grupit Kombëtar Teknik të Punës për Standardin GlobalG.A.P. në Shqipëri ishte një tjetër arritje e realizuar me mbështetjen e RisiAlbania

Certifikimi me GlobalG.A.P. nuk ka të bëjë vetëm me reputacionin, por është një vulë sigurie dhe besueshmërie për konsumatorët në tregun e brendshëm dhe të jashtëm, duke nxitur bizneset që të synojnë eksportet. Sektori agro, volumi i punës të të cilëve është rritur e vlerësojnë si thelbësore certifikimin e GlobalG.A.P.

I. Vazhdon me sukses procesi i certifikimit në grup përmes Shoqërive të Bashkëpunimit Bujqësor (SHBB), për pajisjen e tyre me certifikatën e cilësisë GlobalG.A.P.

(i) Mbas SHBB "Agro ISAK" që ishte subjekti i parë si SHBB, i cili u pajis me certifikatën GlobalG.A.P., falë mbështetjes së Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe

Bashkëpunim SDC, përmes Projektit RisiAlbania. Certifikimi i kësaj SHBB-je me 14 fermerë, na ndihmoi shumë në procesin e certifikimit në grup, pasi shërbeu si një model pozitiv dhe si katalizator, për nxitjen e procesit të certifikimit në grup edhe për SHBB të tjera. Këto ditë u pajis me certifikatën GlobalG.A.P. edhe subjekti "AGRO KONISPOLI", i cili ka në përbërjen e vet 50 fermerë të certifikuar. Sipas të dhënave të GlobalG.A.P. në shkallë botërore 73 % e fermave të certifikuara me certifikatën GlobalG.A.P. janë grupime dhe vetëm 27 % subjekte individuale.

"

Rrapaj:

Certifikimi me Global G.A.P., sipërmarrjet mundësi për gjetjen e tregjeve të reja për eksport me çmime deri 30 % më të larta

(ii) Me mbështetjen e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC, përmes Projektit RisiAlbania në periudhen 2019 e në vazhdim, janë mbështetur disa subjekte si "Doni Fruit", i cili arriti të dyfishojë sipërfaqen e certifikuar me GlobalG.A.P. nga 63 ha në 130 ha. Gjithashtu në këtë proces mbështetje u është dhënë edhe subjekteve "Tomato Al", "LEA 2011", etj., të cilët kanë mundësuar gjetjen e tregjeve të reja për eksport me çmime deri 30 % më të larta se sa shitej i njëjti produkt më parë pa u certifikuar.

(iii) Konstituimi i Grupit Kombëtar Teknik të Punës për Standardin GlobalG.A.P. në Shqipëri, ishte një tjetër arritje e realizuar me mbështetjen e RisiAlbania. Gjithashtu u përgatit nga ky grup dhe u miratua propozimi për MBZHR, për rritjen e mbështetjes dhe masës së financimit të procesit të certifikimit në grup, përmes amendim/shtese në VKM nr.100 datë 05.02.2020, "Për miratimin e kritereve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi programit për bujqësinë e zhvillimin rural, për vitin 2020".

Gjithashtu zyra qendrore e GlobalG.A.P. miratoi edhe përditësimin e kushteve teknike dhe ligjore për GRASP, që realizoi grupi teknik i GlobalG.A.P. në Shqipëri.

Irjana Gjana: Standardi lokal shqiptar (localg.a.p) më shumë siguri për konsumatorin dhe shitje të garantuar

Çfarë rëndësie ka krijimi i grupit teknik për standardin GlobalGAP për Shqipërinë?

Në fakt kjo është një praktikë e ndjekur edhe nga vende të tjera në mbarë botën sipas një infrastrukture të ngritur nga vetë GlobalG.A.P. për miratimin e organizmave të tillë. Në Shqipëri standardi GlobalG.A.P po zë një peshë gjithnjë e më të madhe në certifikimet e kërkuara nga eksportuesit shqiptarë për të aksesuar tregje me interes më të lartë ekonomik, rrjedhimisht dhe nevoja e një grupi teknik që shërben si një strukturë facilituese dhe zhvilluese e udhëzuesve kombëtarë për implementimin e standardit ishte e pashmangshme.

Grupi teknik është ura lidhëse e GlobalG.A.P me vendin tonë në nivel informimi dhe interpretimi të kërkesave të rregullores me kushtet e Shqipërisë. Ne veçse e kemi filluar këtë proces gjatë 2021-shit dhe kemi përfunduar me sukses miratimin e modulit GRASP nga Sekretariati GlobalG.A.P duke u dhënë mundësi kompanive të certifikuara që të aplikojnë këtë modul në njësitë e tyre dhe të përmbushin kërkesa të tilla shtesë që kanë blerës të ndryshëm të tregjeve europiane.

Një ndër qëllimet kryesore të grupit është lobimi ndaj institucioneve qeveritare dhe projekteve të ndryshme për mbështetje në shumë aspekte dhe atë financiar ndaj këtij sektori.

Cila është mënyra e operimit të grupit dhe çfarë aktivitetesh priten në vijim?

Grupi është krijuar në baza vullnetare nga përfaqësues të grupeve të ndryshme të interesit me qëllimin e përbashkët të zhvillimit të mëtejshëm të tregut GlobalG.A.P në Shqipëri. Që në zanafillë të krijimit të tij ka parashikuar një plan aktivitetesh dhe takime periodike për të siguruar një funksionalitet por dhe realizim të qëllimeve të vendosura. Grupi ka parashikuar aktivitete promovuese në zona të ndryshme të Shqipërisë të standardit GlobalG.A.P dhe përmirësimet që sjell ky standard në mënyrë operimi por dhe shitje në tregje europiane, informim ndaj palëve të interesuara dhe lobim për interes të zhvillimit të mëtejshëm të tregut. Sfida kryesore që shtrohet para nesh është hartimi dhe miratimi i Udhëzuesit Kombëtar për standardin GlobalG.A.P. (Integrated Farm Assurance) i cili synon interpretimin e kërkesave të rregullores me kushtet e vendit dhe kuadrin rregullator shqiptar.

Gjithashtu krijimi i një standardi lokal shqiptar (localg.a.p) për produktet e tregtuara në vend është një iniciativë e cila do sillte një siguri të shtuar tek konsumatori, një shitje të garantuar për fermerin dhe një zinxhir të mirë e të sigurt furnizimi për supermarketet shqiptare.

AZHBR nxitje turizmit rural në Roskovec

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR)

përmes Skemave Mbështetëse, synon nxitjen e turizmit rural në zonën e Fierit.

AZHBR njofton se, gjatë takimit që zhvilloi këtë fundjavë, në ambientet e Bashkisë së Roskovecit, me përfaqësues të komunitetit rural dhe të institucioneve vendore, fokus i diskutimeve ishte turizmi rural dhe zhvillimi i investimeve në këtë zonë të Fierit, që ndikojnë në zhvillimin e agroturizmit.

"Tradita, kulinaria, historia dhe biznesi, ndërthuren mjaft mirë në natyrën e larmishme të Roskovecit, duke e shndërruar këtë rajon në një potencial me vlera të veçanta agroturistike", tha kryetarja e bashkisë Fier, Majlinda Bufi.

Bufi shprehu gatishmërinë e qeverisë në zgjerimin e investimeve që ndihmojnë zhvillimin e turizmit rural. Në takim ishin përfaqësues biznesesh dhe sipërmarrës lokal, me interes të lartë në zhvillimin e mëtejshëm dhe investimin në agroturizëm.

Drejtoresha e përgjithshme e AZHBR, Eranda Selmanaj, referoi gatishmërinë e këtij institucioni për të financuar iniciativa të tilla, me vizion të qartë drejt shërbimit, akomodimit, ushqimit dhe programeve rekreative që i shërbejnë turizmit rural.

Në takim u prezantua edhe një broshurë në formën e guidës turistike, që përmban informacione për Roskovecin dhe gjithçka që ofron kjo zonë.

180 pjesëmarrës në paketën e kualifikimit në sektorin e agroindustrisë

Për të rritur cilësinë e shërbimeve dhe produkteve, ka ardhur koha që bizneset të investojnë edhe në kualifikimin e burimeve njerëzore.

Në vijim të kësaj qasjeje, paketa e kualifikimit në vendin e punës për sektorin e agroindustrisë, mbështetur nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me GIZ, u prezantua këtë javë në një takim-bashkëbisedim mes përfaqësuesve të sektorit, shkollave profesionale bujqësore dhe Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.

180 persona do të jenë pjesë e kësaj pakete për sektorin e agroindustrisë me qëllim kualifikimin e tyre në lidhje me nevojat e tregut.

INFORMACIONE

BSH: Është rritur pesha e frutave dhe zarzavateve në inflacion, çmimet të larta, deri më 2023

Vetëm pak muaj më parë, Banka e Shqipërisë deklaroi se çmimet e larta do të ishin kalimtare.

Por tashmë, në linjë edhe me bankat e tjera qendrore në botë, pritshmëritë kanë ndryshuar dhe të paktën edhe këtë vit qytetarët do të duhet të paguajnë më shumë për mallrat dhe shërbimet që blejnë.

Në një prononcim të posaçëm për "Monitor", Banka e Shqipërisë pret që inflacioni të jetë mbi objektivin 3%, në pasqyrim të niveleve të larta të çmimeve në tregjet ndërkombëtare. Banka pret normalizim brenda vitit 2023.

Çfarë tregojnë analizat e reja të Bankës së Shqipërisë rreth ecurisë së inflacionit në vitin 2022?

Për vitin 2022, ne presim që inflacioni të jetë mbi objektivin 3%, në pasqyrim të niveleve të larta të çmimeve në tregjet ndërkombëtare. Me normalizimin e tyre, ne presim reduktimin e inflacionit drejt objektivit, i cili parashikohet të arrihet brenda vitit 2023.

Përditësimi i analizës me informacionin e ri lë të pandryshuar gjykimin tonë mbi faktorët, të cilët po ndikojnë inflacionin, por ai evidenton se goditjet e ofertës po provohen të jenë më të forta dhe më të qëndrueshme se vlerësimet fillestare. Rritja e inflacionit, nga njëra anë, po ndikohet nga faktorë të qëndrueshëm të lidhur me rritjen e kërkesës, punësimit dhe pagave.

Por, gjithashtu, rritja e inflacionit, sidomos prej muajve të fundit të vitit 2021 po ndikohet edhe nga faktorë tranzitorë të lidhur me rritjen e çmimeve energjetike dhe të ushqimeve në tregjet ndërkombëtare. Këto goditje të ofertës dhanë ndikim të konsiderueshëm, duke e shtyrë inflacionin mbi objektivit tonë.

Efekti i goditjeve të ofertës pritet të jetë i pranishëm edhe në vitin 2022, por me një intensitet në rënie në linjë me normalizimin e pritur të situatës në tregjet ndërkombëtare në gjysmën e parë të vitit 2022.

Të dhëna nga terreni që revista "Monitor" ka grumbulluar në zinxhirin e bujqësisë në zonën e Myzeqesë (prodhim, tregtim inputesh dhe eksporte) tregojnë për rënie të sipërfaqes së kultivuar në serra, së paku 25% dhe reduktim të ofertës për prodhime vendi. Çfarë të dhënash ka Banka e Shqipërisë për ecurinë e sektorit bujqësor dhe ndikimin që do të ketë në inflacion?

Të dhënat që ka Banka e Shqipërisë për sektorin bujqësor bazohen, në pjesën dërrmuese të tyre, në informacionin statistikor të publikuar nga INSTAT-i. Këto të dhëna tregojnë se prodhimi bujqësor është rritur mesatarisht me 1% në vit në tetë vitet e fundit, me një tendencë ngadalësuese gjatë viteve 2019 – 2021. Nga ana tjetër, eksportet bujqësore janë rritur me ritme të larta dhe të qëndrueshme (rreth 18.6% në vit), pas vitit 2016.

Në përgjithësi, çmimet e produkteve bujqësore shfaqin luhatshmëri të lartë, e cila ndikohet kryesisht nga faktorë të ofertës – si prodhimi, infrastruktura shpërndarëse dhe magazinuese, etj. – ndërkohë që kërkesa për këto produkte është në përgjithësi e qëndrueshme. Po ashtu, prodhimi bujqësor në vetvete përcaktohet, në njëfarë mase, nga faktorë volatilë e të paparashikueshëm, si kushtet klimatike apo kushtet e tregut ndërkombëtar.

Vlerësimet tona tregojnë se volatiliteti i çmimeve bujqësore, kryesisht ai i çmimeve të frutave dhe perimeve, ka qenë veçanërisht i lartë në vitet e fundit, duke e bërë të vështirë parashikimin e tyre.

Koniunktura aktuale ndërkombëtare, e karakterizuar nga rritja e kostove të inputeve, të transportit dhe çmimeve të ushqimeve bazë sugjeron se artikujt ushqimorë do të vijojnë të jenë kontribuues i qenësishëm në inflacionin në vend në vitin 2022. Më tej, kontributi i tij pritet të vijë më pranë niveleve historike.

Çfarë peshe ka në inflacion zëri fruta, perime dhe zarzavate?

Bazuar në publikimin më të fundit të INSTAT-it mbi shportën e përditësuar të konsumit familjar (janar 2022), rezulton se pesha e frutave dhe zarzavateve në shportën e konsumit është 9.3%. Gjatë viteve 2020 e 2021, pesha e tyre ka ardhur në rritje duke qëndruar rreth 1 p.p. më lart se mesatarja e viteve të mëparshme.

Importet e plehrave bujqësore rënie me 81% në janar, lajmërojnë vështirësi në sektor

Bujqësia ka hyrë në një periudhë të vështirë, ku sipërfaqet e mbjella po reduktohen si pasojë e rritjes së çmimeve të inputeve.

Reduktimi i të mbjellave po sjell efekte negative në të gjithë zinxhirin bujqësor. Të dhënat zyrtare të INSTAT referojnë se importet plehrave bujqësore shënuan rënie me 81 për qind në janar 2022 në raport me të njëjtin muaj të vitit të kaluar.

Gjatë janarit u importuan vetëm 3094 tonë plehra nga më shumë se 16300 tonë në janarin e vitit 2021. Importi mesatar i plehrave në janar gjatë gjashtë viteve të fundit ishte mbi 14 mijë tonë në janar. Rënia është e ndikuar dhe nga pritshmëria për vendosjen e TVSH-së prej 10% për inputet që hyri në fuqi nga janari 2022, çka i nxiti importuesit që të blinin sasi më të mëdha të plehrave kimike në dhjetor të vitit të kaluar.

Importet e plehëruesve në vlerë ishin vetëm 189 milionë lekë në janar nga 659 milionë lekë në janarin 2021.

Arben Sakollari një tregtar i vjetër i inputeve bujqësorë tek "Pushimi i Shoferit" në zonën bujqësore më të zhvilluar në vend, tha se shitjet e plehrave dhe fidanëve kanë rënë dukshëm. Ai tha se nuk ka marrë furnizime të reja pasi nuk ka shumë kërkesë. Ai tha se" Këtë vit nuk bëhet fjalë për luhatje sezonale të sektorit, por me fenomenin e braktisjes, pasi emigrantët që u kthyen nga jashtë vite më parë dhe investuan kursimet në sera tani po ikin sërish".

Eduart Sharka një ekonomist me përvojë që mban bilancet e rreth 200 fermerëve në këtë zonë, thotë se shkaktar kryesor për rënien e prodhimit bujqësor është paketa fiskale e vitit 2022 dhe konkretisht dy masa:

E para, norma e kompensimit të prodhuesit bujqësor nga 6% u bë 0%.

E dyta vendosja TVSH-së 10% të furnizimit të inputeve bujqësore, siç janë plehrat kimike, pesticidet, farat dhe fidanët, përveç hormoneve të klasifikuar në kodet 2937 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, nga zero për qind që ishin deri në fund të vitit 2021.

Sipas zotit Sharka këto masa fiskale ndaj sektorit bujqësor u morën në një periudhe të vështirë pasi çmimet e lëndëve të para po rriteshin, ndërsa çmimet e ofruara për prodhimet bujqësore ishin në rastin më të mirë njësoj ose më të ulëta.

Presionet e dyanshme rriten kostot e prodhimit nga njëra anë dhe të ardhurat nga shitjet ranë. Pothuajse të gjitha serat rezultuan me humbje para se të nisin efektet e paketës fiskale. Me gjithë defektet që kishte skema e subvencionit të TVSH ajo arrinte të mbulonte deri diku humbjet tek fermerët. Edhe pse skema e TVSH -së favorizonte zinxhirin e grumbullimit, fermerët morën çmimet më të larta nga tregtarët e grumbullimit ata pasi arrinin të mbanin një normë të kënaqshme fitimi pikërisht nëpërmjet skemës së kompensimit në bujqësi.

Stimujt u hoqën në një kohë që qeveria nuk kishte menduar një skemë të re kompensimi për fermerët duke bërë që shumë prej tyre prej humbjeve të larta të mos mbjellin për sezonin e ri.

Braktisja e serës sikur edhe një sezon të vetëm, krijon hendek të madh në të gjithë zinxhirin bujqësor dhe më vonë kërkon kosto të dyfishta për ta rimbjellë.

3/4 e kantinave të verërave në 6 rajone - - Sfidat e sektorit, nga aksesi në treg tek paragjykimet për cilësinë

Në vend prodhohen mesatarisht 918 ton verë në vit nga kantinat shqiptare. Industria e përpunimit të verës është e përqendruar kryesisht në disa rajone, konkretisht në Durrës, Berat, Elbasan, Vlorë, Tiranë dhe Shkodër. Sipas studimit të bërë nga Ministria e Bujqësisë dhe GIZ, këto gjashtë qytete përbëjnë afërsisht ¾ e kantinave të verës.

Në studim thuhet se përqendrimi i kantinave të verës i kombinuar me kategorinë e verës së prodhuar (përsa i përket cilësisë) jep indikacione se grupet potenciale të verërave në Berat (në ditët e sotme lider në rajon në verërat cilësore), Durrës, Vlorë, Tiranë dhe Elbasan që, pavarësisht në nivel informal dhe fillestar, mund të orientojnë politikat përkatëse. Por cilat janë sfidat kryesore që kanë prodhuesit vendas? Sipas dokumentit, sfidat kryesore në nivelin e përpunimit lidhen me shfrytëzimin e dobët të kapaciteteve për shkak të aksesit të vështirë në treg.

Arsyet e rëndësishme të raportuara për aksesin e vështirë në treg janë paragjykimi ndaj cilësisë së verës shqiptare, struktura e kostos, konkurrenca e pandershme nga kantinat vendase informale dhe nga verërat e importuara. Po ashtu vështirësia për të siguruar rrush të cilësisë së lartë nga fermerët (kultivarë të papërshtatshëm dhe rrush me cilësi të ulët/me përmbajtje të ulët sheqeri); Mungesa e kapacitetit të prodhimit të verës ose e kapacitetit të prodhimit të rrushit; Ekspertizë e dobët teknologjike në kantina joformale dhe të vogla.

Nga ana tjetër, në studim thuhet se pavarësisht disa interesave të shfaqura nga kantinat e verës që prodhojnë verë të cilësisë së mesme deri në të lartë, nuk ka asnjë kantinë që merr pjesë në skemat e cilësisë së BE-së (PDO, PGI). Po ashtu, marketingu i dobët – raporti i pafavorshëm çmim/cilësi i verërave cilësore, pamundësia financiare për të investuar, kryesisht në kantina të vogla janë disa sfida të këtij sektori.

Rama: Tregu i ri i fruta-perimeve në Durrës, gati brenda marsit

Banorët e qytetit të Durrësit do të kenë brenda muajit mars tregun e ri të fruta-perimeve.

Kryeministri Edi Rama publikoi pamje si ishte dhe si po transformohet ky treg pas punimeve për ndërtimin e tij.

"Ja si ishte dhe si po bëhet tregu i fruta-perimeve në Durrës, që do të jetë gati brenda marsit", tha Rama.

Tregu i ri synon të përmirësojë kushtet e tregtimit duke rritur sigurinë ushqimore për konsumatorët dhe shtuar kapacitetet e tregtimit në të.

TEMA TË DITËS

Krifca në Francë: Mekanizëm për përgjigjen ndaj krizave në tregje pas luftës në Ukrainë

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca mori pjesë në sallonin ndërkombëtar të bujqësisë në Francë, ndër eventet bujqësore më të rëndësishëm në botë.

Krifca bisedoi me ministrin e Shtetit për Evropën, Clement Beaune, lidhur me mbështetjen e Francës për Shqipërinë, por edhe për aktivizimin e mekanizmit të përgjigjes ndaj krizave në tregje të produkteve agroushqimore, pas luftës në Ukrainë.

"Me një axhendë të ngjeshur takimesh frytdhënëse me aktorë kyç të sektorit të bujqësisë, blegtorisë dhe ushqimit, bisedova me ministrin e Shtetit për Evropën, Clement Beaune, lidhur me mbështetjen e Francës. Ndërsa Ministria e Bujqësisë së Francës do të mbështesë Shqipërinë, së bashku, diskutuam dhe për iniciativën e ministrave të bujqësisë së BE-së ndërmarrë si efekt i luftës në Ukrainë për të aktivizuar mekanizmin e përgjigjes ndaj krizave në tregje të produkteve agroushqimore me anë të të cilit nëse do të nevojitet do të asistohen edhe vendet kandidate", tha Krifca.

Krifca u ndal edhe te partneriteti me Francën për adoptimin e teknologjive eficiente në prodhimin bujqësor dhe blegtoral, si dhe kërkoi rritjen e angazhimit në Shqipëri për investime dhe shkëmbim tregtar në fushën e bujqësisë.

Ministri Beaune shprehu vlerësimin për Shqipërinë në hapat e duhur që ka ndjekur për adoptimin e praktikave të mira të prodhimit bujqësor, përafrimin e legjislacionit me atë të Bashkimit Evropian dhe rritjen e prezencës së produktit shqiptar në tregjet evropiane.

Hapet tregu i grurit dhe i misrit, Shqipëri-Serbi rikonfirmojnë marrëveshjen "Ballkani i Hapur"

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca ndodhet në një vizitë zyrtare në Beograd, lidhur me garantimin e funksionimit të tregjeve ushqimore në rajonin tonë.

Ministrja Krifca dhe ministri serb i Bujqësisë, Branislav Nedimovic, kanë konfirmuar hapjen e tregut dhe lëvizjen e lirë të grurit dhe misrit ndërmjet Serbisë dhe Shqipërisë.

Në kuadër të marrëveshjes "Ballkani i Hapur", pavarësisht se për tregjet e tjera ndërkombëtare mund të jenë mbyllur, gruri dhe misri nga Serbia do të lëvizin lirisht në drejtim të tregut dhe konsumatorit shqiptar.

"Në një takim me ministrin Nedimovic në Beograd, patëm mundësinë të diskutojmë edhe njëherë marrëveshjen e "Ballkanit të Hapur" edhe në kushtet në të cilat gjendemi tani si dhe për të siguruar që kjo marrëveshje funksionon. Kontratat e lidhura tashmë për importin dhe eksportin e produkteve të ndryshme, përfshirë atë të misrit apo të grurit do të vijojnë normalisht", tha Krifca.

Ministrja theksoi se, "ne garantuam njëri-tjetrin për një

bashkëveprim dhe bashkërendim institucional të mirëkuptuar dhe është shumë e rëndësishme që kompanitë shqiptare do të kenë mundësi që kësaj jave do të mund të vijojnë biznesin e tyre normalisht për importet e grurit dhe misrit. Ky është një shembull i mënyrës se si marrëveshja e "Ballkanit të Hapur" krijon lehtësira edhe në periudha shumë të vështira".

Vizita dhe takimi mes dy ministrave për garantimin e funksionimit të marrëveshjes së "Ballkanit të Hapur", veçanërisht për tregtinë e lirë të mallrave ushqimorë, vjen në një moment të vështirë për tregjet, të cilat janë bllokuar nga lufta në Ukrainë.

Krifca me ministrin francez për Europën: Rritje e tregtisë ushqimore mes dy vendeve

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca mori pjesë në sallonin ndërkombëtar të bujqësisë or-

ganizuar në Francë, që vlerësohet si eventi bujqësor më i rëndësishëm në botë.

Me një axhendë të ngjeshur takimesh me aktorë kyç të sektorit të bujqësisë, blegtorisë dhe ushqimit, ministrja Krifca bisedoi edhe me ministrin francez të Shtetit për Europën, Clement Beaune, lidhur me mbështetjen e Francës për Shqipërinë.

Beaune shprehu vlerësimin për Shqipërinë në hapat e duhur që ka ndjekur për adoptimin e praktikave më të mira të prodhimit bujqësor, përafrimin e legjislacionit me atë të Bashkimit Europian dhe rritjen e prezencës së produktit shqiptar në tregjet europiane.

Beaune gjithashtu garantoi ministren Krifca për mbështetjen franceze në rritjen e tregtisë ushqimore mes dy vendeve.

Në këtë kuadër u diskutua dhe për iniciativën e ministrave të bujqësisë së BE-së për të aktivizuar mekanizmin e përgjigjes ndaj krizave në tregje dhe çmime të produkteve agroushqimore me anë të të cilit nëse do të nevojitet do të asistohen edhe vendet kandidate.

Krifca theksoi rëndësinë e partneritetit me Francën për adoptimin e teknologjive eficiente në prodhimin bujqësor dhe blegtoral, si dhe kërkoi rritjen e angazhimit francez në Shqipëri për investime në fushën e bujqësisë dhe rritjen e shkëmbimeve tregtare.

Krifca takon Prentis: Zgjerim i marrëdhënieve tregtare me Anglinë

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Frida Krifca gjatë vizitës zyrtare që zhvilloi

në Londër, në kuadër të samitit të organizuar nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), me liderët e Ballkanit Perëndimor, mbi investimet dhe perspektivën ekonomike të vendeve të rajonit, takoi ministren e Bujqësisë, Ushqimit, Mjedisit dhe Zhvillimit Rural të Anglisë, Viktoria Prentis.

"Ishte kënaqësi e veçantë të takoja në Londër ministren e Bujqësisë, Ushqimit, Mjedisit dhe Zhvillimit Rural të Anglisë, Viktoria Prentis", u shpreh Krifca.

Krifca vuri në dukje se, si partnerë politikë e strategjikë me Anglinë, i shprehu dëshirën dhe u dakordësuan mbi potencialin e pashfrytëzuar dhe gatishmërinë institucionale për të mundësuar zgjerim të marrëdhënieve tregtare mes vendeve tona.

Gjithashtu, theksoi Krifca, "diskutuam edhe për forcimin dhe ndërveprimin e nevojshëm në fushën e bujqësisë, ushqimit, sigurisë ushqimore dhe zhvillimit rural".

Mbi 3600 fermerë pajisen me NIPT në dy muaj - Rritet interesi për të përfituar nga fondet në bujqësi

Skemat financuese të fermerëve të aplikuara nga Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural vit pas viti kanë nxitur edhe ndërgjegjësimin e tyre për tu formalizuar dhe për t'u pajisur me niptin përkatës, si kriter kryesor për të qenë përfitues. Sipas të dhënave më të fundit të tatimeve të përpunuara nga TV SCAN, aktualisht janë 66.642 fermerë aktiv, ndërsa vetëm në dy muajt e parë të vitit që i paraprijnë hapjes së aplikimeve për Skemën Kombëtare të Subvencioneve 2022, janë pajisur me nipt 3674 fermerë, numër ky shumë i lartë po të marrim parasysh ecurinë e përgjithshme.

Qarqet që kanë pasur fluksin më të lartë të pajisjes me nipt janë Fieri, Korça, Elbasani, Berati dhe Vlora, ndërsa ma pak fermerë të regjistruar rezultojnë në Lezhë dhe në Sarandë. Numri i fermerëve të pajisur me Nipt është rritur vit pas viti, dhe po ta krahasojmë me 2018-ën, regjistrohen mbi 25 mijë fermerë të formalizuar në një periudhë 3 vjecare.

Megjithatë, po të marrim parasysh se në total janë 354 mijë fermerë, rezulton se vetëm 18.8 për qind prej tyre janë të formalizuar dhe që kanë akses në fondet për bujqësinë, si në skemat shtetërore edhe në ato të Bashkimit Europian që aplikohen përmes programit IPARD, duke bërë që më shumë se 80 për qind të jenë informalë.

Më 25 Shkurt, Agjencia Për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural ka hapur aplikimet për 13 skema mbështetëse përmes Skemës Kombëtare, ku fond i vënë në dispozicion në total është 3.2 miliardë lekë, nga të cilat rreth 1 miliardë lekë do të shkojnë për naftën falas në bujqësi. Feremerët e pajisur me nipt nuk kanë asnjë detyrim tatimor për të paguar.

"Çmimi i bukës po rritet artificialisht" - Shoqata apel furrave: Bëni kujdes nga e blini miellin!

Furrat e bukës kanë filluar të shesin produkte me çmime të rritura. Sipas Shoqatës së Bukës, Pastiçerisë dhe Brumrave kjo rritje është artificiale pasi është vënë re një diferencë shumë e madhe e çmimit midis shitjes nga fabrikat dhe çmimit që blihet furrat.

"Ky është në përgjithësi një abuzim që nuk justifikohet për kushtet konkrete kur të gjithë ne duhet të mbajmë barrën më të madhe, në mënyrë që tek klientët tanë të mos shkojë shumë e ashpër rritja e çmimit të bukës. Ne ju bëjmë thirrje të gjithë menaxherëve dhe tregtarëve që marrin miellin nga fabrikat dhe e dërgojn në furrat e bukës, të bëjnë kujdes në këto moment, të gjithë ne jemi pjesë zinxhir i furnizimit të popullit me bukë, dhe të gjithe ne duhet të sillemi me pergjegjësi në keto situata të veshtira. Situatat mund të vijnë edhe të rendohen, ndaj neve të gjithë duhet të mendojmë qe popullit të mos rrisim artificialisht çmimin e bukës", thuhet në deklaratën e Shoqatës.

Sipas kësaj shoqate në disa

rrethe furnizim me miell po bëhet nga persona të veçantë te cilët po bëjnë rolin e sekserit, duke u futur në treg dhe duke rritur artificialisht çmimin e miellit në furrat e bukës. Për këtë arsye u bëhet apel furrave të bukës, që para se të bëjne furnizimin me miell, të bëjnë verifikimin e duhur pranë fabrikave, në mënyrë që të kuptojnë se me cfarë çmimi del mielli nga fabrika dhe me çfarë çmimi vjen ne furrë, në mënyrë që të mund të ndalohet abuzimi me çmimin nga ana e ketyre seksereve. Sipas Shoqatës, të gjithë furrat duhet të jenë të kujdeshme që mos rrisin çmimin për konsumatorët, pasi mund të vijnë situata më të vështira.

MEKANIZIM

Rinovimi i mekanikës bujqësore, nevojë për t'a bërë fermerin konkurrues në tregun rajonal

- Braktisja masive nga të rinjtë, e veprimtarisë dhe pronave në zonat rurale, zgjidhja: Programe afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, për rritjen dhe intesifikimin e mekanizimit, inovacionit dhe dixhitalizimit në bujqësi dhe në të gjithë sektoret e Ekonomisë së Ushqimit në Shqipëri.

- Fermerët në Shqipëri disponojnë 1.5 traktorë për 100 ha tokë bujqësore, Maqedonia e Veriut për të njëjtën sipërfaqe disponon 4 herë më shumë traktorë se Shqipëria, BE 6 herë më shumë, kurse Italia 8 herë më shumë. Zgjidhjet janë lehtësitë fiskale dhe financimi përmes granteve dhe kredive me kushte lehtësues për importin e traktorëve, makinerive bujqesore, pajisjet për inovacionin dhe dixhitalizimin.

(Vijon nga numri i kaluar)

Sipërfaqja e vogël e fermave

Gjendja aktuale

Bujqësia është e sunduar nga ferma me sipërfaqe të vogël (mesatarisht 1.13 hektarë) dhe të copëzuara në mesatarisht 3.9 parcela për fermë, me një madhësi mesatare prej 0.25 hektarësh. Parcelizimi i tokës bujqësore sjell një sërë vështirësish për prodhimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore, dhe ka bërë që përdorimi në shkallë të gjerë i mekanikës bujqësore tëjetë i vështirë.

Për të adresuar këtë problem, dhe për të forcuar më tej pozitën ekonomike të fermerëve në vitin 2012 u miratua ligji 38/2012 për Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor. Ky ligj krijon kushtet e përshtatshme ligjore që megjithëse fermat në shqipëri janë në sipërfaqe të vogël, bashkimi i fermerëve në Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor, në lidhje me shërbimet që kryen shoqëria ndaj fermerëve, si psh. shërbimet në fushën e prodhimit bujqësor apo marketingut, shërbimet në veprimtarinë e punës bujqësore, apo dhe në fushën e bashkëpunimit për inputet, fermat trajtohen si të bashkuara.

Megjithatë, ky ligj ka pasur probleme gjatë zbatimit të tij për shkak të vështirësive që krijohen në organizimin e fermerëve dhe në formalizmin e menjëhershëm të një sektori që është thellësisht i ndikuar nga informaliteti.

Keshilli Agrobiznesit Shqiptar (KASH) dhe Enti Kombetar Rural (EKR) janë angazhuar për një kohë të gjatë dhe kanë ndërmarrë shpesh inisiativa për të nxitur procesin e kooperimit të fermerëve përmes konsolidimit të SHBB në Shqipëri. Por pengesat dhe vështirësitë kanë qenë të mëdha.

Pengesë dhe veshtirësi jo e vogël për t'u kapërcyer ishte dhe mbetet eksperienca negative që fermerët shqiptarë pësuan nga dështimi i ish kooperativave dhe Ndërmarrjeve Bujqësore Shtetërore në sitemin e centralizuar socialist. Ka vite që po punohet për të ndërtuar dhe prezantuar një model të ri kooperimi për të bindur fermerët për domosdoshmërinë e tij. Disa donatorë kanë marrë inisiativa e kanë financuar edhe projekte pilot për të ndërtuar modele kooperimi të përshtatshme për Shqipërinë por këto inisiativa e projekte pilot nuk u arrit të zhvillohen më tej. Një ndër aresyet pse mbeti i izoluar ne vitin 2012 modeli Spanjoll për kooperimin dhe SHBB ishte mungesa e mbështetjes nga Ministria e Bujqësisë dhe qeveria për zgjerimin dhe konsolidimin e këtij procesi dhe kësaj inisiative.

U kërkua nga fermerët dhe donatori në atë periudhë që ministria dhe qeveria si hap të parë të amendonin pa humbur kohë ligjin 38/2012 "Për Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor" SHBB. Mbasi ishte një ligj i papërfunduar dhe nuk i shërbente realizimit të qëllimit dhe objektit për të cilin ishte hartuar. Këtij ligji i mungonte dhe i mungojnë edhe aktualisht pjesë mjaft të rëndësishme që duhet të rregullojnë statusin e SHBB dhe Federatave të SHBB, që të përcaktohet qartë dallimi midis SHBB dhe SHPK. Ligji ka probleme edhe në procesin e rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, mbasi programi QKB nuk përcaktohen qartë modalitetet e regjistrimit. SHBB mbas regjistrimit ne QKB interpretohet nga organet tatimore indentik dhe pa asnjë dallim siç interpretohet edhe SHPK. Ligji nuk përcakton qartë e saktë edhe mbështetjen teknike dhe financiare që duhet t'u jepet SHBB dhe Federatave të SHBB. U kërkua që në strukturën e Minstrisë së Bujqësisë të kishte minimumi një sektor që të mbështeste procesin e kooperimit të fermerëve dhe konsolidimit të SHBB. Për zbatimin e ligjit 38/2012 për SHBB u kërkua të dilnin edhe disa akte nënligjore si udhëzime, urdhëra e rregullore por aktualisht nuk ka dalë asnjë nga këto akte.

KASH dhe EKR duke filluar nga viti 2014 e në vazhdim janë angazhuar dhe po punojnë me komunitetin e fermerëve për të kapërcyer vështirësitë që ekzistojnë tek Ata si rezultat i mentalitetit dhe eksperiencës së hidhur të së kaluarës. U është kërkuar ndihmë edhe donatorëve për të ndihmuar me eksperienca pozitive, për të prezantuar modele të përshtatshme për t'u zbatuar në Shqipëri dhe për të mbështetur me financim grant asistencën teknike për konsolidimin e procesit të kooperimit dhe veçanërisht të SHBB dhe Federativë të tyre.

Fillimi procesit ishte i mbarë. Rezultatet ishin premtuese. Ftesës së bërë donatorëve për mbështetje të kooperimit dhe SHBB iu përgjigj pozitivisht Qeveria e Japonisë e cila përmes Agjensisë JICA dërgoi nga marsi 2014 – maj 2014 një ekip me ekspertë të fushës që studio, analizoi dhe la disa rekomandime për Ministrinë e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave. Për ndërgjegjësimin e fermerëve për zhvillimin e kooperimit dhe konsolidimin e SHBB u nënshkrua edhe një Memorandum Mirëkuptimi midis MBZHRAU, EKR dhe Kooperativës së Unionit të Kursim Kredisë aktualisht (FED Invest). Shoqatat e KASH u angazhuan në mbështetje të inisiativës duke nxitur e bindur për t'u riaktiviziuar 13 SHBB e krijuara deri ne vitin 2013 dhe ka përkrahur inisiativat për krijimin e SHBB të reja dhe brenda pak kohësh në vitin 2015 numri i SHBB arriti në 64. Këshilli Ministrave miratoi propozimin për ndryshimin strukturës së MBZHRAU dhe u krijua edhe sektori i posacëm i mbështjes së kooperimit dhe SHBB. Shumë SHBB filluan nga aktivitetet dhe për t'u evidentuar është aktiviteti zhvilluar nga SHBB "Agroservisi Shqiptar" e cila ka mbi 100 anëtarë, ka kryer operacione efiçente për blerje në grup të traktorëve dhe mjeteve të mekanikës bujqësore me çmime mjaft konkurruese. Ka aplikuar në grup për sigurimin e financimit për rinovimin e parkut të traktorëve me projekte mjaft konkuruese. SHBB "Agroservisi Shqiptar" ka përgatitur edhe disa projekte konkrete për reduktimin e kostove në sektorin që mbulon. Në bashkëpunim me "FEDERUNAKOMA" Itali u organizua në Tiranë edhe edicioni parë dhe i dytë i Panairit Ndërkombëtar i Mekanikës Bujqësore dhe linjave të agropërunimit për Europën Juglindore. Gjithashtu filloi mbarë puna për kooperimin dhe krijimin e SHBB edhe në sektorin e perimeve, të frutave dhe atë të blegtorisë. Dhe përsëri procesi kooperimit dhe konsolidimit të SHBB nuk eci sipas parashikimit dhe nuk u arritën rezultati që duam.

Nga MBZHRAU nga viti 2014 e në vazhdim nuk pati interesin e duhur për bashkëpunimin me Japoninë. Nuk u ndoq seriozisht puna për të zbatuar në kohë rekomandimet e bëra apo për t'i kthyer një përgjigje donatorit, që në rastin konkret ishte JICA. Nuk u zbatuan kërkesat që parashikonte Memorandumi midis saj dhe shoqatave të fermerëve për sektorin e kooperimit. Nuk funksionoi me efiçencë dhe nuk u plotësua me ekspertë të kualifikuar sektori kooperimit i krijuar në MBZHRAU. Nuk u amendua dhe nuk doli asnjë akt nënligjor për ligjin 42/2012 të SHBB. Organet tatimore vazhduan t'i trajtojnë SHBB si SHPK duke i ndëshkuar ato në shumë raste padrejtësisht me gjoba tepër të mëdha dhe të papërballueshme. Gjoba të cilat mbas shumë përpjekjesh tashmë janë anulluar nga gjykatat. Por dëmi është shkaktuar. SHBB për këto arësye e kanë pezulluar apo ngrirë veprimtarinë e tyre.

BERZH, BE dhe Qeveria Shqiptare mbështesin turizmin dhe agrobiznesin

Programi për ndarjen e riskut me Bankën Intesa SanPaolo në Shqipëri deri në 5.17 milionë Euro

• BERZH nënshkruan një marrëveshje për ndarjen e riskut deri në 5.17 milionë Euro me Bankën Intesa SanPaolo në Shqipëri.

• BE dhe qeveria ofrojnë 10 për qind grant nën Programin për Mbështetjen e Agrobiznesit dhe Turizmit në Shqipëri

• Deri më sot janë akorduar 70 milionë euro hua për 6000 SME.

Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), Banka Intesa SanPaolo në Shqipëri dhe Bashkimi Europian (BE) dhe Qeveria Shqiptare ofrojnë mbështetje për bizneset në sektorët e agrobiznesit dhe turizmit nën Programin e BERZH për Mbështetjen e Agrobiznesit dhe Turizmit në Shqipëri.

BERZH përmes një programi për ndarjen e riskut do të ofrojë deri në 5.17 milionë Euro për Bankën Intesa SanPaolo në Shqipëri për hua në sektorin e agrobiznesit dhe turizmit. Fondet do të akordohen përmes Programit të BERZH për Mbështetjen e Agrobiznesit dhe Turizmit për të lehtësuar qasjen në financime për sipërmarrjet e vogla dhe të mesme në partneritet me bankat tregtare në Shqipëri.

Instrumenti do të përfitojë nga një incentivë prej 10% për huamarrësit në sektorin e turizmit dhe agrobiznesit me fondet e Qeverisë Shqiptare dhe BE. Huatë për investimet e kapitalit do të mund ta përfitojnë grantin pas përfundimit dhe konfirmimit të investimit. Programi gjithashtu përfshin nga një mekanizëm për Mbulimin e Humbjeve të Para me kontributin e Qeverisë Shqiptare.

Ekaterina Solovova, Drejtoreshë e BERZH në Shqipëri tha: "Kjo marrëveshje përfaqëson një tjetër hap të rëndësishëm për këtë program të përbashkët me BE dhe Qeverinë Shqiptare. Ne jemi të lumtur të mbështesim sektorët e turizmit dhe agrobiznesit në Shqipëri dhe të rrisim më tej bashkëpunimin e shkëlqyer me Bankën Intesa SanPaolo në Shqipëri. "

Alessandro D'Oria, Drejtor i Përgjithshëm i Intesa SanPaolo Bank në Shqipëri shtoi: "Kjo marrëveshje do të nxisë zhvillimin e financimeve të qëndrueshme në sektorin e agrobiznesit, që është një nga prioritetet tona strategjike për vitet në vijim. Banka Intesa SanPaolo në Shqipëri ka mbështetur gjithnjë sektorin e turizmit përmes programeve të huasë. Përfshirja e turizmit nën këtë program ofron një mundësi të shkëlqyer për mbështetjen e sektorit dhe krijimin e vendeve të reja të punës për të rinjtë."

Rreth 180 milionë euro janë alokuar për këtë program për hua dhe përmes ndarjes së riskut me bankat partnere në vend. Prej fillimit të tij në 2016, mbi 70 milionë euro hua janë ofruar për rreth 6100 biznese vendase në sektorin e agrobiznesit. Programi ka qënë komplementar me programin IPARD të Bashkimit Europian, disa prej përfituesve të të cilit kanë marrë edhe financime nën AATSF.

Krahas instrumentave financiare, BERZH ofron dhe asistencë teknike për institucionet financiare dhe huamarrësit përmes programit të BERZH për Këshilimin e Bizneseve të Vogla në Shqipëri.

BERZH është një investior lider në Shqipëri e fokusuar në zhvillimin e sektorit privat, rritjen e shpirtit të sipërmarrjes në ekonomi, komercializimin e projekteve infrastrukturore dhe promovimin e energjisë së qëndrueshme dhe investimeve të sigurta mjedisore. Deri më sot, Banka ka investuar 1.78 miliardë euro në 125 projekte në Shqipëri.

INPUTET BUJQËSORE

Kriza e çmimeve të bazës materiale të bujqësisë (inputeve) na thërret për një "patriotizëm të gjelbër"

Përgatiti Prof. Ass. Enver ISUFI
Instituti i Bujqësisë Biollogjike, Durrës

Shkurt, 2022

Ndërsa shteti mundohet të reagojë me shtesën e buxhetit për mbështetjet e bujqësisë, rritja e çmimeve të inputeve si plehra, produkte për mbrojtjen e bimëve, farëra, fidana, impjante ujitje, pjesë këmbimi për mekanizmat bujqësore janë rritur jashtë parashikimeve.

Prof. Ass. Enver ISUFI

Në fakt kështu pritej. Pandemia globale e COVID 19, harxhoi shumë nga dhjami i vendeve të zhvilluara, dhe ato kanë reaguar me çmimet e larta të bazës materiale për bujqësinë. Kjo situatë krize globale, po shoqërohet edhe me një çorientim psikologjik të politikës botërorë.

Pritej që periudha past COVID 19, të shoqërohej më një aleancë botërorë për rigjallërimin e ekonomisë, por kjo nuk po ndodh, përkundrazi. Kjo situatë na bën të mendojmë me këmbë në tokë për sigurinë ushqimore kombëtare. Shqipëria tashmë fatmirësisht ka një kurorë për mbrojtjen kombëtare, por nuk ka kurorë mbrojtjeje ndaj krizave ekonomike globale dhe krizat e shkaktuara nga ngrohja globale, të cilat sipas parashikimeve priten të shpeshtohen. Thatësirat, përmbytjet, ngricat, zjarret, priten të jenë më të shpeshta, pikërisht nga ndryshimet klimatike globale. Vetë studimet shkencore në të gjitha fushat e bujqësisë, lipsen të rishikohen, sepse parametrat klimatikë kanë ndryshuar, e për pasojë biologjikë e bimëve dhe të parazitëve kanë spostime, diku më herët, diku më vonë. Pra edhe studimet shkencore bujqësore, duhet të jenë sa më afër situatës klimatike kombëtare, dhe jo të zbatojmë praktika bujqësore, fotokopje e vendeve të zhvilluara.

Shqipëria është duke korrur aksionet e shaktrrimeve të ekonomisë tonë kombëtare e cila filloi pas viteve 1990.

- Shkatërruam fabrikat e plehrave kimike, ato azotike dhe fosforike.

- Shkatërruam rrjetin kullues dhe vaditës. Parcelizimi, si makro-infrastrukturë e bujqësisë, gjithashtu u shkatërrua.

- Desh zoti nuk hodhëm në erë edhe hidrocentralet, se do kishim përfunduar fare në hal..t.

- Naftën nuk e dimë se ku shkon dhe si e kush e menaxhon.

- Mineralet e tjera, gjithshtu askush nuk di se ku shkojnë dhe sa fiton Shqipëria.

Jemi në kohë për gjallëruar atë që mund ta quajmë «patriotizëm të gjelbër»

Kjo lëvizje duhet të fillojë me rritjen e ndërgjegjes kombëtare dhe patriotike në radhë të parë nga rinia shqiptare.

Para çlirimit të vendit nga Lufta e Dytë Botërore, qindra specialistë e studentë, të cilët kryen studimet jashtë shtetit, u kthyen në Shqipëri për të marë pjesë në luftë edhe për të ngritur ekonominë shqiptare pas shkatërrimit nga lufta.

Sot nuk dëgjojmë as nga shkolla, familja, media, arti, sporti, të ketë programe edukimi patriotik për këtë plagë që sa vjen e zmadhohet, pikërisht depopullimi i vendit nga forcat e gjalla njerëzore.

Një stan me plot bagëti, me dele lopë dhe dhi, është më i bukur dhe i gjallë, se sa një bllok vilash, ku nuk banon asnjë njeri.

Tani dua të theksoj se si mund të kompensohen disa nga sasitë e plehrave kimike dhe produkte të mbrojtjes së bimëve, duke përdorur rezervat tona natyrore dhe njohuritë tona shkencore.

Prodhimi i plehrave nga çdo biomasë organike

1. Ndërtimi i fabrikave të riciklimit të biomasës organike të të gjitha llojeve dhe prodhimi i plehut organik të tregtueshëm.

Vetëm Shqipëria nuk ka fabrika të tilla. Qyteti i Barit në Itali, ka disa prej tyre. Ndërsa prodhuesit dhe eksportuesit e plehrave kimike, ndërtojnë biznese të plehut organik, Shqipëria që i blen i shpërdoron mbetjet organike në mënyrën më të papranueshme. Qyteti i Tiranës dhe Durrësit të paktën të kishin nga një fabrikë të tillë. Kemi pasur përvojë të mirë në prodhimin e plehut organik.

Çdo ekonomi bujqësore (kooperativëosefermështetërore), kishte të ashtëquajturat "Brigada të grumbullimit dhe përpunimit të plehut organik" Tirana si qytet, kishte shumë brigada të tilla të prodhimit të nitratit organik.

2. Kthimi në sistem i kompostimit që nga niveli familjar dhe në familjet fermere

3. Përdorimi i plehërimit të gjelbër për plehërim të tokës.

Kodrat tona gjatë dimrit dhe verës kanë ngjyrë kafe, jo të gjelbër. Këto kodra me vreshta, ullishte, pemë frutore duhet të gjelbëronin nga mbjellja me bimë azoto-prudhuese si batha, bizelja, tërfili etj.

4. Qarkullimi bujqësor, i cili përdor vlerat agronomike të një bime në funksion të bimës pasardhëse, menaxhon më mirë lëndët ushqyese (NPK) në tokë.

5. Kompostime të mbetjeve pas vjeljeve, pas krasitjeve, pas përpunimeve (si llojet e bërsive, mbetjet pas ekstratimit të bimëve mjeksore) etj.

6. Fabrikat e tharjes dhe paketimit të plehut të pulave, leshterikëve të bregdetit si një rezervë shumë e madhe për kufizimin e plehrave kimike. Projektet IPARD, duhet t'i kthejnë sytë edhe tek këto fusha investimi.

Me keqardhje pranojmë se krahasuar me sistemin ekonomiko-shoqëror sakat, që me dëshirë e përbysëm, prodhojmë sot më pak grurë, më pak misër, më pak naftë, më pak krom dhe bakër, më pak filma, më pak këngë, më pak teatër, më pak ushtri, më pak rini, më pak tokë të punuar.

Sot ekonomia jonë ka krijuar edhe gjera të mira, të cilat nuk janë pak, por kjo është vetëm kurora e pemës shqiptare, rrënjët janë të cekta. Qëndrushmërinë nuk e përcakton madhësia dhe bukuria e kurorës, por rrënjët e thella të kësaj peme. Lartësia e një banese nuk duhet lakmuar, nëse themelet nuk përballojnë as tërmetin katër ballësh. Një ekonomi në borxhe, nuk flet për rrënjë të thella dhe të sigurta. Një pagë e ulët mesatare, nuk flet për themele të thella sociale.

Psh. Themelet e energjisë ekologjike e ndërtuar në Shqipëri, 50 vite më parë janë të thella. Shqipëria mburret sot para botës se 95 % të energjisë e kemi të pastër. Edhe ne kishin miniera qymyri, por nuk dominoi energjia me burim qymyret. Kjo nuk u bë rastësisht dhe pa kulturë profesionale. Absulutisht jo. Shqipëria i njeh sot korifejtë e energjitikës shqiptare të tipit Inxhinierin e nderuar Farudin Hoxha me shokë. Asnjë shqiptarë nuk e beson që kjo ndodhi pa një strategji të hartuara paraprakisht.

Pse Kosova sot energjinë elektrike në 95 % të saj e siguron nga burimet jo ekologjike. Kjo sepse Millosheviçët, nuk hartuan për Kosovën strategji afatgjata për prodhimin e energjisë të pastër ekologjike.

Pra rasti i energjisë elektrike quhet qëndrueshmëri. A është qëndrueshmëri që të blesh bukën nga jashtë vendit, dhe me cilësi të dobët. Nuk po ankohemi pse i blejmë të gjitha pajisjet elektronike dhe makinat. Ne nuk i prodhojmë ato. Por edhe sheqerin, edhe cigaren, edhe orizin, edhe grurin e blejmë.

Kur flasim për grurin ende gjejmë argumente fëminore të cilët thonë, "grurin e blejmë nga jashtë, sepse blihet lirë". Pse vendet e zhvilluara, të gjithë në të njëjtën kosto e prodhojnë grurin? Pse e prodhojnë grurin vetë?

Gruri nuk është vetëm bukë. Gruri është ushqim edhe për blegtorinë e shpendët, është shtresë për blegtorinë, është kashtë për industrinë, është blerim për ekologjinë, është vlerë për qarkullimin bujqësor.

Pse jemi në këtë tokë të bekuar me plot ujë dhe dritë, vetëm për të vegjetuar e mbijetuar, apo për të jetuar duke prodhuar?

Vetëm se u mobilizuam, prodhimin e vendit ne sot, pjesën më të madhe të perimeve e prodhojmë vetë (para 20 viteve kur prodhimi i vendit mori goditjen më të madhe, blenim nga Maqedonia, deri barë për blegtorinë)

Vetëm një markë uji të pishëm, kishim në fillim të viteve 1990. Sot kemi ngritur industrinë tonë të ujit të pijshëm, madje eksportojmë.

Pra na duhet një strategji kombëtare për përdorimin e burimeve vendave organike për prodhimin e plehrave për bujqësinë, duke ngritur kështu një sistem të qëndrueshëm të prodhimit të plehrave organike.

Kufizimi i përdorimit të produkteve për mbrojtjen e bimëve

Edhe në fushën e mbrojtjes së bimëve kemi rezerva për të kursyer përdorimin e produkteve të mbrojtjes së bimëve (insekticideve, fungicideve dhe herbicideve).

1. Organizimi i prognozë-sinjalizimit, i cili na ndihmon të kryejmë trajtimet kimike në kohën e duhur dhe vetëm kur është e nevojshme

2. Dhënia përparësi kultivarëve rezistentë ndaj sëmundjeve kryesore të bimëve, të cilët kërkojnë më pak produkte të mbrojtjes së bimëve.

3. Zgjerimi i mekanizimit në kultivimin e bimëve, për kufizimin e herbicideve.

4. Shtimi i studimeve themelore dhe atyre në fermë për mbrojtjen e bimëve.

5. Forcimin e shërbimit këshillimor dhe diversifikimin e tij me atë privat, dhe me organizatat jo qeveritare që operojnë në bujqësi.

6. Dixhtalizimi i sektorit të mbrojtjes së bimëve

Një alarm i madh pozitiv, një stres i madh pozitiv që fatmirësisht po përjetojmë dhe do përjetojmë akoma më shumë në të ardhmen, është bumi turistik, i cili në 10 vitet që vijnë do të njohë kulme të reja. Bujqësia dhe mjedisi do të jenë ato, të cilët do të kënaqin barkun biologjik edhe syrin estetik të turistëve, por do të kënaqë edhe xhepin ekonomik të shqiptarëve.

Në Zvicër, kohët e fudit pati një diskutim të gjërë, se çfarë do të bëhet me rritjen e çmimeve të ushqimeve.

U shtrua pyetja: të rezistojmë me këto çmime, apo të shtojmë importin bujqësor. Shumica e popullsisë mbështetën idenë që të rezistojmë me çmime realtivisht të larta, dhe jo të dëmtojnë prodhimin bujqësor vendas.

Importi më i lirë siguron qetësi afatshkurtër, rritja e prodhimit të vendit siguron qendrueshmëri afatgjatë. Pra Zvicra demonstroi në lloj patriotizmi të gjelbër.

(Vijon nga faqja 2)

Thirrja për aplikime e hapur për idetë e turizmit të qëndrueshëm

2. Objektivat e Thirrjes

Synimi i RisiAlbania është të rrisë kapacitetet e operatorëve turistikë vendas për të promovuar paketa të qëndrueshme turistike, duke ndjekur standardet ndërkombëtare[1] dhe në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Turizmit[2] dhe t'u mundësojë atyre akses në segmente dhe tregje të reja turistike. Ftojmë operatorët turistikë vendas të paraqesin propozimet që mund të zbatojnë me mbështetjen e RisiAlbania. Ne do të mbështesim propozimet që promovojnë produkte turistike që shtrihen përtej sezonit të lartë dhe synojnë turizmin e qëndrueshëm, propozime që do t'u mundësojnë TO-ve të përputhen me kriteret specifike të standardeve të turizmit të qëndrueshëm (si GSTC ose të tjera) në produktet ekzistuese ose të reja, propozime që promovojnë tematikë rrugë dhe ide të tjera që u mundësojnë operatorëve turistikë të kenë akses në tregje të qëndrueshme kombëtare dhe ndërkombëtare. Pritet që rritja e aksesit në tregjet e turizmit të qëndrueshëm do të rezultojë në rritje të shitjeve dhe krijimin e vendeve të punës në operatorët turistikë, bujtina dhe biznese të tjera turistike. Kriteret e mëposhtme do të merren parasysh në zgjedhjen e propozimeve:

• Produktet e reja të qëndrueshme janë zhvilluar dhe organizuar në bashkëpunim me bizneset dhe komunitetet rurale, në përputhje me rekomandimet standarde të qëndrueshme.

• Udhëtimet krijojnë vende të reja pune, direkte dhe indirekte, për të rinjtë dhe të rejat (për shembull, duke sjellë turistë në zona të largëta ku banorët vendas mund të shesin shërbimet e tyre).

• Paketat turistike organizohen gjatë sezonit të ndërmjetëm ose dimrit dhe/ose zgjasin kohëzgjatjen e qëndrimit gjatë sezonit të pikut dhe plotësojnë standardet e qëndrueshmërisë.

• Të paktën 30% e një nate qëndrimi të turneve zhvillohen në fshatra rurale ose qytete të vogla të largëta: kjo do të thotë se ndërsa turneu mund të përfshijë vendet kryesore turistike, ai duhet të mbulojë edhe zonat rurale.

• Paketat turistike të paraqitura për thirrjen duhet të jenë të qëndrueshme nga ana mjedisore, sociale dhe ekonomike (tregoni mekanizmat, proceset dhe mjetet e përdorura: në mbrojtjen e ndërveprimeve kulturore dhe trashëgimisë, objekteve; në ruajtjen e burimeve dhe reduktimin e ndotjes, gjurmën e karbonit etj). Aplikantët duhet:

• Të jetë i regjistruar në agjenci turistike hyrëse në Shqipëri dhe të ketë një histori të dëshmuar në shitjen dhe drejtimin e paketave turistike.

• Keni lidhje me agjencitë ndërkombëtare dhe mund t'i përdorni këto lidhje për të promovuar paketa të reja udhëtimi.

• Të kenë kanalet e tyre të marketingut si faqet e internetit dhe mediat sociale. Çdo propozim duhet të specifikojë se çfarë lloj mbështetjeje do të kërkohet (shih seksionin 3 më poshtë).

3. Përmbajtja e propozimit

Propozimi duhet të specifikojë strategjinë për marketingun dhe promovimin e paketave turistike dhe nevojën për mbështetje nga RisiAlbania:

• Pasqyra e biznesit. Pasqyrë e shkurtër e biznesit tuaj duke përfshirë stafin, vëllimet e shitjeve dhe numrin e klientëve gjatë të paktën 3 viteve të fundit.

• Strategjia e vizionit dhe e rritjes. Paraqisni vizionin e rritjes së biznesit në afat të mesëm dhe afatgjatë? Ku e shihni kompaninë tuaj në të ardhmen? Çfarë dëshironi të ndryshoni? Shpjegoni pse dëshironi ta ndryshoni dhe si do ta bëni.

• Strategjia e marketingut. Një përshkrim i shkurtër i paketave tuaja turistike të qëndrueshme që do të promovohen duke përfshirë vendndodhjen gjeografike dhe pikat unike të shitjes. Siguroni një analizë të qartë konkurruese të produkteve të tjera konkurruese në tregun shqiptar. Shpjegoni se cilin treg të ri synon dhe pse besoni se ka kërkesë për një produkt të tillë. Jepni një strategji marketingu se si planifikoni t'i shisni paketat turistike në tregjet e reja dhe parashikimet e numrit të turistëve dhe në kohë.

Vlerësoni parashikimet e shitjeve dhe nëse një rritje e shitjeve do të çojë në zhvillimin e paketave të tjera të ngjashme, etj. Kur është e zbatueshme, përfshini një përshkrim të llojit të mbështetjes që operatori turistik u ofron bizneseve rurale për të siguruar respektimin e standardeve (p.sh. trajnimet e mikpritjes, rrjeti i informacionit, trajnime për shpëtimin dhe ndihmën e parë, këshilla për restaurimin

(Vijon në faqen 13)

KËSHILLI I AGROBIZNESIT SHQIPTAR

SHOQATAT ANËTARE

AVALB | FEDINVEST | BKFSH | EKR | IBMA | HABA | AOA | UPM | LEAA | ADAMA | ABA | SHGF | ALBAFLOR

SHKPVF | RKUK | SVP | MSHKM | BIOADRIA | PPAM | SHT | UOTSH | KEA | BIOPLANT | ADAD | PSN

KËSHILLAT RAJONALE

TIRANA | DURRESI | FIERI | ELBASANI | SHKODRA | DIBRA

LEZHA | GJIROKASTRA | KORÇA | BERATI | VLORA | KUKESI

www.kashalbania.org

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

KREDI PËR ÇDO SIPERMARRËS

KREDI E SHPEJTË ME NORMA KONKURRUESE

deri në
7 MILIONË
Lekë

FED invest

GJITHMONË FINANCË SOCIALE

PROFIL

Petro Laboviti, agronomi i talentuar i dy sistemeve

Puna dhe përpjekjet e tij na mësojnë sesi të krijojmë një jetë më të mirë e të sigurtë, për fëmijët tanë dhe brezat që vijnë

Nga: Koço Mosko, Agronom i Mbrojtjes së Bimëve
Boston, MA - SHBA

Jeta e një agronomi në Shqipërinë e prapambetur ka qenë shumë e vështirë, e mbushur plot sakrifica, por edhe me kënaqësinë e veçantë që ka ky specialitet, falë fryteve të punës. Aktiviteti i agronomit ka të bëjë me ushqimin dhe mirëqenien e një populli të tërë. Si në periudhën e Monarkisë Zogiste,

Petro Laboviti, (1912 - 1977)

ashtu dhe në atë të ashtuquajturën socializëm, një specialist i mirë dhe i përkushtuar bujqësie, ndikonte dukshëm në të ardhurat, në nivelin e jetesës dhe ushqimin e njerëzve. Kështu ata u bënë njerëzit më të dashur e të respektuar nga të gjithë. Një i tillë, shumë i veçantë, ka qenë edhe agronomi i talentuar dhe njeriu i mirë, Petro Laboviti. Të gjithë ata që e kanë njohur dhe kanë bashkëpunuar me të, flasin me dashuri e respekt, me fjalët më të zgjedhura e më të mira. Kam qenë gjithmonë i mendimit se njerëz të tillë apo praktika të mira bujqësore duhen evidentuar e shkruar sepse përbëjnë historinë, bazën e traditave tona të mira në bujqësi dhe shërbejnë si frymëzim e përvojë e vyer për brezat.

Familja Laboviti

Petro ishte vëllai më i vogël i tre vëllezërve e dy motrave. Vëllai i parë ishte doktor Vasili i Madh, siç e quanin në Gjirokastër, Vasil Labovitin, "Nderi i Kombit". Doktor Vasili në Gjirokastër, gjatë luftës antifashiste ishte kthyer në një legjendë. Duke qenë se ishte shkolluar në Austri dhe njihte gjuhën gjermane, ai ndikoi me autoritetin dhe opinionin e tij tek komandanti i forcave gjermane për të ndalur gjakderdhjen dhe masakrat mbi njerëzit e pafajshëm të Gjirokastrës. Doktori e kishte pasur shok universiteti në Grac komandantin gjerman. Për këtë ka shkruar në mënyrë letrare Ismail Kadare tek romani "Darka e Gabuar", ndërsa një portret më të plotë të tij na e ka dhënë inxhinieri Shpëtim Emiri në librin e tij "Përmendorja e munguar".

Familja Laboviti ishte një nga familjet e mëdha fisnike gjirokastrite. Në vitet 1960 kam banuar shumë afër shtëpisë së Labovitëve, në lagjen Varosh. Kujtoj se që nga shtëpia e tyre, sjelljet në lagje e kudo, kjo familje të imponte respekt e nderim. Origjina e tyre ishte nga fshati Labovë e Kryqit, mbiemri i tyre i hershëm ishte "Çavo". U shpërngulën për shkaqe që nuk dihen mirë dhe në shekullin e 19-të ishin të vendosur në fshatin Dhuvjan të Dropullit. Dashurinë që kishin për fshatin e origjinës së tyre e ruajtën fort tek mbiemri, ashtu si shumë shumë patriotë të tjerë në ato vite. Petro lindi më 14 qershor të vitit 1912 në Dhuvjan. Gjyshi dhe babai tij në atë periudhë punononin në Gjirokastër. Gjyshi i Petros, Filipi, ishte kryetar i Gjykatës së Apelit, baba i tij, Telemaku, punonte mjek dhe drejtor i spitalit në Gjirokastër. Të dy, si gjyshi dhe i ati, kishin studjuar në Stamboll, Athinë dhe Paris. Prej andej kishin sjellë frymën liberale, iluministe e përparimtare të qarqeve intelektuale të atyre shteteve, dashurinë dhe respektin për njerëzit. Ndërsa nëna e tyre, Aretia vinte nga një familje tjetër e madhe gjirokastrite, e Hidajve. Me këtë edukatë dhe kulturë elitare u rritën dhe u edukuan vëllezërit Laboviti.

Vitet e Shkollimit

Në vitin 1920 familja Laboviti shpërngulet e tëra në qytetin e Gjirokastrës ku Petrua kreu shkollën fillestare 6-vjeçare, sot

shkolla "Koto Hoxhi". Në vitet 1927-1932 mbaroi studimet në shkollën e mesme në qytetin e Korfuzit të Greqisë. Këtu Petrua u shqua për rezultate të mira jo vetëm në mësime, por edhe në aktivitete sportive si në not e futboll. Ai përfaqësonte shkollën e tij gjatë kampionateve lokale të futbollit.

Në vitet 1932-1936, Petrua mbaroi studimet në Fakultetin e Agronomisë pranë Universitetit Nancis të Francës ku u diplomua inxhinier-agronom. Studimet i përfundoi me rrezultate të shkëlqyera. Në përfundim të studimeve pati oferta për t'u punësuar në vendet ku kishte kryer praktikat mësimore universitare si në Francë dhe në Gjenova të Italisë. Petrua vendosi të kthehej në Shqipëri, ashtu siç kishin bërë më parë i ati i tij, Telemaku dhe vëllai i madh, Vasili. Theksojmë se shpenzimet për studimet e tij shkollore e universitare i përballonte familja nga buxheti i vet.

Në vitet e shkollimit Petrua nuk i shkëputi kurrë mardhëniet me shokët e tij të vendlindjes në Dhuvjan dhe atyre të lagjes Varosh e Palorto në Gjirokastër. Që nga kjo periudhë tek Petrua lindi dashuria për njerëzit e thjeshtë dhe natyrën. Ai shkrihej në mes tyre sepse donte ta jetonte jetën në të tëra dimensionet e saj, materiale, intelektuale dhe shpirtërore. Në pushimet shkollore gjatë verës në vitet 1930, Petro aktivizohet lojtar në ekipin e futbollit të klubit "Shqiponja" të Gjirokastrës, sot klubi sportiv "Luftëtari".

Agronom në Shkodër e Lezhë

Në vitin 1937, me mbarimin e studimeve, prej Monarkisë së mbretit Zog, Petrua emërohet agronom në Shkodër dhe në vitin 1938 transferohet në Lezhë, ku punoi deri në fund të vitit 1941. Jo rastësisht atë e dërguan në një zonë bujqësore siç ishte Zadrima, me tradita të hershme në kultivimin e bimëve, por edhe me probleme të shumta të kohës. Kjo zonë në atë periudhë kishte shumë nevojë për një agronom të përgatitur siç ishte Petrua. Për aktivitetin e tij nuk kemi dëshmi nga njerëz e bashkëpuntorë, por kemi shënimet e detajuara që ai ka lënë pas, si një intelektual me kulturë perëndimore. Për një agronom të ri të sapodiplomuar në këtë rajon bujqësor, ku shkenca kishte depërtuar pak ose aspak, punët ishin të shumta. Kryesisht, në mënyrë tradicionale, ose primitive, kultivoheshin vreshta, misri, gruri, duhani, ulliri, perimet, etj. Puna duhej filluar në themel, nga sistemimet e kullimi i tokave, me plugimet cilësore, duhej shtuar mekanika, duhej të përzgjidheshin farërat e fidanat më të mira vendase e të huaja, etj.

Sëmundjet dhe dëmtuesit e bimëve në atë kohë jo vetëm në Zadrimë, por kudo në Shqipëri, bënin kërdinë. Në vreshtari, ku kjo zonë shquhej më shumë, dëmprurëse e shkatërruese ishin filoksera, vrugu, tënja dhe hiri, të ardhura në Europë prej kontinentit amerikan, aty nga pjesa e dytë e viteve 1800. Në Shqipëri këta dëmtues nuk njiheshin ose njiheshin fare pak, e aq më keq masat e luftimit të tyre. Në shënimet e Petros vërejme se ai është marrë shumë me këto probleme dhe doemos me përgatitjen e lëngut bordolez. Problem të veçantë përbënte edhe urthi i grurit, ndryshku, etj. Përveç punës së tij arë më arë e shtëpi më shtëpi Petrua për këto probleme organizoi shumë kurse të shkurtra ditore deri dhe 6-mujore për trajnimin e bujqve vendas duke aplikuar teknikat shkencore agronomike më të mira të kohës që ai kishte mësuar në universitet dhe literaturën shkencore të kohës që kishte në dispozicion.

Ai ishte i pakursyer e i gjithanshëm në ndihmesën që u jepte bujqve e komunitetit vendas. Çdo gjë që bënte, e kryente me pasion e dashuri. Së bashku me intelektualë të tjerë organizoi fushata për edukimin shëndetësor dhe higjienën personale si dhe veprimtari të ndryshme artistike e sportive për të gjallëruar jetën shoqërore e kulturore. Organizoi edhe disa shfaqjeve teatrale artistike për banorët e qytetit të Lezhës. Ishte një njeri i thjeshtë dhe i dashur për bujqit, respektohej nga të gjithë. Organet lokale të pushtetit në Lezhë si dhe Ministria e Bujqësisë së asaj kohe, e vlerësuan punën e këtij agronomi të ri, shumë energjik dhe të gjithanshëm.

Pavarësisht dëshirës së madhe, pasionit për punët agronomike, lidhjeve, njohjeve e miqësive të shumta që kishte krijuar në Lezhë, jeta larg familjes po i vështirësohej sepse vendi kishte hyrë në Luftën e dytë Botërore. Në fund të vitit 1941, mori vendim të kthehej pranë familjes në Gjirokastër. Në vitin 1942, Petro fillon punë sërisht si agronom i Prefekturës së Gjirokastrës, të cilën e ndërpreu në fund të vitit 1943, për shkak të ashpërsimit të luftës. U shkëput nga punët në veri, Shkodër e Lezhë, po jo nga të gjitha. Petrua atje kishte lënë gjysmën e tij, Jorgjinë, shkodranen fisnike, gjimnazisten e bukur që i kishte rrëmbyer zemrën. Ajo do ta shoqëronte gjatë gjithë jetës. Në shtator të vitit 1942, pavarësisht pasigurisë e luftrave, dasma nuk u ndal, ajo u bë sipas traditave e zakoneve fisnike shqiptare, lunxhiote. Ata krijuan një familje të shëndoshë. Lindën, rritën, edukuan dhe shkolluan një vajzë dhe një djalë, Erietën dhe Viktorin.

u emërua përgjegjës i ekonomisë në Komitetin Ekzekutiv të Rrethit të Gjirokastrës dhe më pas Kryeagronom i Qarkut dhe Rrethit, detyra këto që i mbajti deri në vitin 1957. Në vitin 1951, kur u krijua Instituti i Lartë Bujqësor në Kamëz, sot Universiteti Bujqësor i Tiranës, Petrua u thirr për të marrë pjesë në stafin akademik. Nuk pranoi edhe kësaj radhe sepse ndjente që në rrethin e Qarkun e Gjirokastrës kishte shumë punë për të bërë për bujqësinë. Ndryshimi sapo kishte filluar.

Ndodhën shumë ndryshime politike e shoqërore, të paparashikuara. U ashpërsua në kulm lufta e klasave "ndaj borgjezëve të qytetit dhe kulakëve në fshat". U tjetërsua prona private dhe u formuan kooperativat bujqësore sklavëruese. Megjithë qëndrimin e tij prej patrioti e intelektuali të ndershëm si dhe kontributin që i kishte dhënë Lëvizjes Nacional-Clirimtare, Petron, ashtu si dhe shumë intelektualë të tjerë nga shtresat e pasura, të cilët kishin studjuar në Perëndim, do ta ndiqte nga pas, tërë jetën e tij, hija e etiketimit "borgjez", dhe ndonjëherë akoma më keq, frika e të dyshuarit për "sabotator". Kjo sidomos nga persona

Familja Petro Laboviti (Foto e parë në vitin 1940 të fejuar dhe në vitin 1970 me femijët: Viktorin dhe Erietën

Agronom në Gjirokastër

Lufta e Dytë Botërore solli shkatërime të mëdha. Shqipëria doli nga kjo luftë në një gjendje shoku, tepër e drobitur dhe shumë e mjeruar. Bujqësia ishte shpresa që mund të bënte diçka për rimëkëmbjen e shpejtë, përmirësimin e kësaj varfërie e urie të tejskajshme që kishte pllakosur qytete e fshatra. Petrua u angazhua që në ditët e para të çlirimit në misionin e tij fisnik e jetësor, në sigurimin e ushqimit të përditshëm për njerëzit e varfër e të uritur. Fillimisht të indoktrinuar, injorantë dhe ambiciozë, të ngritur në pushtet, "vlera" e tyre e vetme ishte hipokrizia, injoranca, intriga dhe servilizmi.

Petrua iu përkushtua punës, me gjithë forcën e mendjes dhe të fizikut të tij për të përçuar në bujqësinë e rrethit dhe Qarkun e Gjirokastrës bazat e organizimit shkencor. Në kushte teje të vështira, më shumë në këmbë, në shi e dëborë, si agronom i vetëm në atë kohë, ai e përshkoi kryq e tërthor Qarkun nga Vurgu i Sarandës në Përmet, Pogon, Lunxhëri, Labëri, Zagori, etj… Siç mbajnë mend familjarët e tij, u ndesh me vapën përvëluese, llucën, mushkonjat dhe shumë herë morrat, pleshtat e çimkat që i sillte me vete kur kthehej në shtëpi. Me gjithë këto vështirësi, ai qëndronte me ditë të tëra në këto zona midis fshatarëve të thjeshtë e të varfër, me ata që kishin shumë nevojë për mendjen e këshillat e tij agronomike. Ai kontribuoi dukshëm që ata të dilnin nga mizerja dhe gjendja e rëndë e urisë. Mjeku vetriner Sotiraq Paskali tregon:

- Ato pak vite që punova me Petron mësova shumë gjëra prej tij, sidomos sinqeritetin dhe korrektësinë në punë. Ishte një specialist i kompletuar me kulturë perëndimore, i thjeshtë, punëtor i palodhur. E shikoje krahinë më krahinë, në çdo cep të rrethit, fushë apo mal.

Ndërsa ish drejtori i shkollës së Mesme në Lazarat, Zija Basha kujton:

- Në arat tona Petrua mblidhte shpesh bujq nga Dropulli, Libohova, Suha Erindi, Mashkullora, Picari, etj. dhe u tregonte përvojën tonë bujqësore. E mbaj mend agronom Petro Labovitin si një burrë i hollë e i gjatë, i veshur gjithmonë me kostum e kravatë e me një pardesy gri. Kur ecte rrugicave të qytetit e në sheshin e Çerçizit respektohej e nderohej nga të gjithë si shkencëtar, intelektual e qytetar shembullor.

Punët e shumta që duhesh të kryheshin në bujqësi, ai i nisi me punimet bonifikuese, sistemimin e tokave, punimet e mekanizuara dhe sistemet e plugimit të tokave. Organizoi për këto probleme kurse e seminare me bujq e mekanizatorë. Gjatë këtyre viteve toka nënkulturë u rrit me 47 përqind më shumë, në krahasim me vitin 1938. Petrua si një specialist me kulturë perëndimore, rekomandonte përdorimin e faktorëve stimulues për bujqit. Për këtë, i kënaqur, ai shkruan në kujtimet e tij:

- "Viti 1950 karakterizohet jo vetëm nga shtimi i sipërfaqeve të bimëve industriale, por edhe nga zbatimi në shkallë shumë më të gjerë i udhëzimeve agroteknike si: afatet e mbjelljeve, përdorimi i plehrave, shërbimeve kulturale, etj. Kjo falë rritjes së çmimeve të blerjes së bimëve industriale, të cilat i shtynë bujqit të zgjerojnë sipërfaqet dhe të zbatojnë më mirë udhëzimet agroteknike".

Në kushtet sesi ndodhej atëherë Lugina e Drinos, ku kryesisht shtrihen tokat bujqësore të rrethit të Gjirokastrës, vëmendje të veçantë Petrua tregoi për kulturat bujqësore që i përmirësojnë dhe i pasurojnë tokat, si jonxha, tërfili, batha, etj. Në shënimet e tij, ai shkruan: "Kultura e jonxhës para çlirimit pothuajse nuk njihej fare në këtë rreth".

Agronomi Thanas Xhumba kujton:

- Jonxha në Dropull nuk njihej. Petrua si specialist shumë i përgatitur, duke i njohur mirë

(Vijon në faqen 13)

KËSHILLA NË SHËRBIM TË FERMERËVE

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË, SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE FUSHË KRUJË

TEKNIKA E RRITJES DHE E MBARËSHTIMIT TË ZOGJVE BROJLER, DHE PËRDORIMI I RACIONIT USHQIMOR ME USHQIME TË PELETUARA

Privatizimi i ekonomisë dhe në këtë kuadër, intensifikimi i zhvillimit të blegtorisë në vendin tonë u shoqërua natyrshëm edhe me zgjerimin e sektorit të shpendarisë për vezë dhe për mish. Mbarështimi i shpendëve përbën një sektor me rëndësi për ekonominë bujqësore Shqiptare, zhvillimin e industrisë përpunuese dhe përmirësimin e furnizimit të popullsisë me mish dhe vezë. Pra mbarështimi i shpendëve përfaqëson një burim të rëndësishëm për sigurimin e nevojave ushqimore për popullatën. Gjithashtu mbarështimi i shpendëve në sajë të kostos së leverdishme dhe aftësisë së tyre prodhuese për të konvertuar ushqimet në proteina shtazore përbën një sektor me rëndësi, pra është një degë e rëndësishme e prodhimit blegtoral në vendin tonë dhe në botë. Industria e shpendëve ka fituar një eksperiencë dhe një rritje të vazhdueshme gjatë 20 viteve të fundit. Sot përdoren linja hibride për vezë e mish me aftësi të larta prodhuese, teknologji të përparuara të rritjes dhe racione të balancuara. Qëllimi kryesor i mbajtjes së shpendëve është shndërrimi me efektivitet i ushqimeve të ndryshme në vezë e mish, produkte me vlera të larta për njerëzit. Ndër speciet e shpendëve që mbahen për qëllime ekonomike janë pulat, patat, gjeli i detit, rosat, e më rrallë mbarështohen speciet e tjera si fazani, pëllumbi, struci etj. Rritja e prodhimit të mishit të shpendëve mbështetet në, përgatitjen e ushqimeve me vlerë të plotë biologjike, në zbatimin e një mbarështimi racional mbi baza shkencore, në sigurimin e mikroklimës, dhe zbatimin e masave efikase të profilaksisë dhe karantinës veterinare. Rritja e shpendëve për prodhim mishi ka marrë zhvillim të shpejtë vitet e fundit. Mishi merret nga zogjtë brojler, gjelat e detit, patat, rosat etj. Brojlerët mund të rriten në grupe umiforme në mënyrë ciklike gjatë gjithë vitit. Rritja e shpejtë e brojlerëve dhe përvetësimi i mirë i ushqimeve jep mundësi të prodhohet mish me shpenzime minimale. Prodhimi ciklik i mishit të zogjve brojler lejon shfrytëzimin racional të ndërtesave, pajisjeve dhe ul koston e prodhimit të mishit. Një shpend i seleksionuar për prodhimtari të lartë mund të shprehë potencialin e tij gjenetik nëse rritet në kushte optimale. Rritja në mënyrë intensive për prodhimin e mishit bazohet në hibridet (komerciale). Hibridet manifestojnë një shpërblim të mirë të ushqimit, një karkasë të cilësisë të lartë dhe një zhvillim të mirë të mbulesës puplore. Hibridet e mishit janë ARBOR, KOBB, HYBRO, SHAVER, ROSS. Në vendin tonë shfrytëzohen shumë mirë hibridet për mish si: KOB, ROSS që kanë pesha të vogla trupore dhe mbahen për një periudhe rritje 35-42 ditë. Për çdo 1 kg masë të gjallë trupore zogjtë brojler harxhojnë rreth 1.8- 2.1 kg ushqim të balancuar. Mbarështohen nga pularitë e Kavajës, Lushnjës, Korcës, Fierit, Fushë Krujë etj. COBB ROSS janë të njohur në të gjithë botën për koston më të ulët të prodhimit të mishit të pulës. Këto hibride janë të njohur për performancën superiore në të gjithë treguesit e rritjes, koefiçient të mirë të shpërblimit të ushqimit. Këto arrihen në sajë të një menaxhimi të mirë, që shoqërohet me një ndriçim natyral të zogjve, dhe me një dietë ushqimore të përshtatshme, tregues të cilët ndikojnë direkt në uljen e kostos së ushqimeve, si faktor primar, që ul koston e prodhimit total të mishit.

Faktorët që ndikojnë direkt në koston e prodhimit të mishit janë:

- konvertimi i ushqimit,
- çmimi i ushqimit,
- sasia e mishit të prodhuar.

Mishi i brojlerve paraqet vlera të konsiderueshme biologjike dhe ushqimore, ka tretshmëri dhe vlerë të lartë ushqyese. Muskuli është lehtësisht i ndashëm nga yndyra. Është i pasur me vitamina, mbi të gjitha të grupit B, acid linoleik, hekur dhe zink. Prodhimi i mishit në brojler vlerësohet nga disa tregues si: pesha e gjallë në kohën e therjes, kohëzgjatja e periudhës së rritjes, shtesa mesatare ditore e peshës, sasia e ushqimit të konsumuar për 1 kg shtesë peshë, rrezja e mishit etj. Ai varet nga faktorë biologjikë dhe të mjedisit. Për këtë, të ushqyerit duhet të lidhet me një mbarështim sa më të mirë, me një gjendje të mirë shëndetësore të shpendëve dhe më një menaxhim kompetent. Me futjen e hibrideve të rinj për mish, me përmirësimet në fushën e të ushqyerit dhe kushteve të ambientit, është rritur prodhimi i mishit të brojlerëve, duke shkurtuar afatin e mbajtjes së zogjve dhe duke e bërë mishin e tyre një produkt mjaft të leverdishëm dhe me një përdorim të gjerë praktik.

Teknologjia e rritjes së brojlerëve dhe menaxhimi i tyre

Përpara arritjes së zogjve

Për të garantuar zogj sa më vitalë, pastrohen dhe dezinfektohen mirë lokalet dhe rregullohen pajisjet, që tu japë mundësi zogjve ti afrohen lehtësisht ujit dhe ushqimit pas arritjes së tyre. Ngrohet më parë lokali dhe stabilizohet temperatura dhe lagështia para arritjes së zogjve. Klloçkat ndizen 24 orë para se të vijnë zogjtë. Enët e ujit duhet të mbushen 2 orë para se të vijnë zogjtë. Ushqimi duhet të jete i thërmuar, i situr, pa papastërti. Për të arritur një performancë të mirë, zogjtë duhet të vendosen në fermë, në ambjentet, ku do të bëhet rritja e tyre sa më parë që të jetë e mundur. Gjatë 10 ditëve të para të jetës, zogjtë janë mjaft të ndjeshëm ndaj ndryshimit të ambientit, që ndryshon prej atij të inkubatorit. Mangësitë në 24 orët e para të jetës ndikojnë negativisht në performancën e tyre.

Kualiteti dhe performanca e zogjve

Kualiteti i zogjve është i lidhur me shëndetin, të ushqyerit mirë, si edhe një menaxhim të mirë të inkubimit. Nëqoftëse zogu është i një cilësie të mirë, dhe ka një menaxhim të mirë, gjatë javës së parë, mortaliteti duhet të jetë i ulët dhe pesha e gjallë arrihet me uniformitet optimal. Zogjtë reagojnë ndjeshëm ndaj mungesës së ujit, i cili duhet tju sigurohet menjëhere pas çeljes. Gjatë transportit zogjtë duhet të mbahen në kondita të tilla, që të eleminohet dehidratimi dhe stresi. Është shumë e rëndësishme që të mbahen standarte të larta të higjenës, dhe të biosigurisë në inkubator dhe gjatë transportit. Mbajtja gjatë e zogjve në kuti mund të shkaktojë një shkallë të lartë dehidratimi që mund të rezultojë në një mortalitet dhe redukton rritjen e tyre në 7 ditët e para dhe peshën finale të tyre. Sapo të vijnë zogjtë, shkarkohen dhe vendosen shpejt në lokal, dhe duke siguruar që ushqimi dhe uji të merren menjeherë. Enët e ushqimit e të ujit, nuk duhet të mbeten asnjëherë bosh, por të mbushen vazhdimisht.

Teknika e rritjes

Aplikohet në dy ose tre faza. Kur rritja aplikohet me dy faza:

- **Faza e parë** përfshin periudhën e mbarështimit për të gjithë zogjtë në moshën 0- 21ditë
- **Faza e dytë** përfsshin periudhën 22 ditë deri në therje (35-42 ditë)

Ritja e zogjve gjatë javës së parë është një proces delikat, sepse ato kanë mjaft kërkesa ndaj kushteve të mjedisit dhe higjenës.

Kryesore në kushtet e mikroklimës është temperatura e mjedisit e cila në ditën e parë të jetë 30˚. Temperatura e mjedisit në lokal ulet me 2˚ në javë (0,5˚në ditë) derisa arrihen kufijtë normal për ritjen e zogjve 24˚C. Lagështia duhet të jetë 70%. Kufiri minimal 50%. Në ditët e para lagështia duhet të jetë 70 %. Dendësia e krerëve për m² varet nga mosha, pesha dhe gjendja e lokalit

Në dy ditët e para vendosen letra gjatë gjithë gjatësisë së lokalit, në masën 25 % të sipërfaqes së dyshemesë pranë enëve të ushqimit dhe të ujit, ku hidhet ushqimi, që zogjtë të kenë mundësi të hanë ushqim me bollëk dhe të pijnë ujë të freskët, sepse në të kundërt mund të ketë ngordhje nga uria apo nga dehidratimi i organizmit. Pastaj hiqen letrat dhe përdoren enët e ushqimit, që nuk duhet të mbeten asnjëherë bosh. Kontrollohet furnizimi me ujë, i cili nuk duhet të mungojë për asnjë çast. Këshillohet që në të njëjtin ambient, të mos ketë tufa zogjsh me mosha të ndryshme. Diferenca e moshës së zogjve të mos jetë më shumë se 7-12 ditë.

Kontrolli i ambientit. Temperatura, lagështira, ventilimi, ndriçimi.

Menjëherë pas ardhjes së zogjve kontrollojmë treguesit ambientale, që duhet të jenë në këto parametra:

- Temperatura e ajrit - 30 ◦ C
- Lagështia relative 60- 70 %.
- Ventilimi duhet të jetë pa korente ajri, për të siguruar ajër të freskët, dhe për të lëvizur gazet e dëmshme, lagështinë e tepërt dhe nxehtësinë. Zogjtë janë të ndjeshem ndaj korenteve të ajrit, prandaj shpejtësia e ajrit duhet të jetë më pak se 0,15 m/sek.
- Ndriçimi është shumë i rëndësishëm në prodhimtarinë e brojlerve, dhe kohëzgjatja e tij programohet deri në 23 orë në ditë.

Intensiteti i dritës duhet të jetë jo më pak se 20 lux për të stimuluar aktivitetin e zogjve. Javën e parë duhet të jetë 30 – 40 lux. Në fund të periudhës së rritjes, 3 ditë para therjes, intensiteti dritës ulet në 10 – 5 lux. Densiteti: Rekomandohet të vendosen deri 33 kg peshë e gjallë / m²

Kujdesi për zogjtë, dhe kontrolli i marrjes së ushqimit dhe ujit.

Gjatë 24 orëve të para kontrollohen zogjtë pas arritjes për tu siguruar që të gjithë kanë gjetur ushqimin dhe ujin. Kontrollohet lehtësisht gusha e zogjve (30- 40 zogj) nga 3-4 vende të ndryshme në lokal.

Mbushja e gushës pas 24 orësh. Bëhet vlerësimi i mbushjes së gushës së zogut në kohë dhe në vëllim sipas këtyre parametrave:

Koha e mbushjes së gushës (orë)	(% e zogjve me grykë të mbushur)
2 orë	75 %
12 orë	më e madhe se 85%
24 orë	më e madhe se 95%

Drejtoria e Teknologjive Blegtorale: QTTB- Fushë Krujë:
E-mail:qttbfushekruje@yahoo.com

(Vijon në numrin e ardhshëm)

KËSHILLA NË SHËRBIM TË FERMERËVE

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË BUJQËSISË, SIGURISË USHQIMORE DHE ZHVILLIMIT RURAL

QENDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE VLORË

(Vijon nga numri i kaluar)

REKOMANDIME PËR FERMERËT NË LIDHJE ME SHËRBIMET KRYESORE NË PEMËTARI PËR JAVËT NË VAZHDIM

Krasitja formuese është ndërhyrja në vitet e para të zhvillimit të pemës dhe qëllimi i saj është të sigurojë një rritje të ekuilibruar, funksionale dhe estetikisht të kënaqshme, një formim të degëve të forta të pozicionuara nga njëra-tjetra në pikën e duhur (në mënyrë që të lejojë një depërtim më të mirë të dritës) dhe të nxisë bimën që të futet sa më shpejt në prodhim. Kjo lloj krasitje duhet të kryhet detyrimisht në periudhën e parë të jetës së bimës në qoftë se duam që struktura e saj të formohet në mënyrën e duhur. Ndërhyrjet e mëvonshme të krasitjeve shërbejnë për të konsoliduar dhe për të përmirësuar këtë strukturë.

Një krasitje formuese e kryer në një mënyrë profesionale lehtëson në masë të madhe, duke i bërë më efektive ndërhyrjet nëpërmjet krasitjes në fazat e mëvonshme.

Për të kryer në mënyrën më të mirë të mundshme krasitjen formuese është e nevojshme të njihet mënyra e zhvillimit natyral të bimës mbi të cilën do të bëhet ndërhyrja. Pemë të ndryshme frutore (por në përgjithësi të gjitha bimët) kanë mënyrën e tyre të zhvillimit, kanë një sjellje tipike që duhet të përmirësohet dhe të menaxhohet nëpërmjet krasitjes formuese në funksion të asaj se çfar duam të realizojmë. Kultivarët e rinj dhe nënshartesat e reja që përdoren në ditët e sotme në pemëtari kanë një sjellje të ndryshme nga ajo e këtyre bimëve në të kaluarën apo të bimëve që ndodhen në natyrë. Kjo e bën të domosdoshme njohjen e karakteristikave të tyre edhe nga krasitësit profesionistë.

Gjatë krasitjes duhet të largohen të gjitha degët që rriten në mënyrë të çrregullt dhe që me rritjen e tyre pengojnë formimin e natyrshëm të strukturës së bimës, duke prishur pamjen dhe funksionin e tyre. Vazhdohet me largimin e degëve që janë të dëmtuara nga sëmundjet, si dhe me shkurtimin e degëve që janë më të dobëta se të tjerat për të stimuluar dhe rritjen dhe forcimin e tyre. Largohen gjithashtu degët që janë të mbivendosura dhe rrallohen kur janë të shumta në numër, në mënyrë që të lejojnë rrezet e diellit për të arritur çdo pjesë të bimës.

Prerjet e bëra duhet të jenë sa më të pastra, duke përdorur mjetet e duhura, për evitimin e dëmtimit të lëvores dhe të mundësohet sa më shpejtë mbyllja e plagëve. Sipas rastit në krasitjet formuese mund të jetë e nevojshme përdorimi i tutorëve për orientimin e dëshiruar të degëve, që mund të jenë të natyrave të ndryshme (sistem mbështetës, lidhje plastike, etj).

Krasitjet ndryshojnë pak a shumë rrënjësisht arkitekturën e bimës dhe njëkohësisht edhe vendndodhjen e rezervave të saj. Format e mbajtjes së pemëve janë nga më të ndryshmet por tendenca është që në varësi të nënshartesës, tipit të tokës dhe nivelit të agroteknikës, kurorat të jenë sa më të ulta nga toka për të lehtësuar shërbimet vjetore dhe vjeljen pa nevojën e shkallëve.

Në krijimin e formave të detyruara (palmeta), duke qenë se nuk janë në të njëjtën linjë me sjelljen natyrale, kërkojnë prerje më të rënda gjatë formimit të tyre, duke ndikuar në zgjatjen e kohës së nevojshme për krijimin e strukturës së tyre. Përkundrazi, format e reja ("moderne") të kultivimit, që përpiqen për të përshtatur format natyrore të bimëve, nxisin futjen më shpejtë në prodhim, duke ndikuar në reduktimin e stresit si pasojë e prerjeve dhe ndjeshmërinë ndaj parazitëve.

Krasitja formuese e pemëve frutore parashikon si fazë finale krasitjen prodhuese e cila kryhet kur pema ka hyrë në prodhim, megjithëse edhe gjatë kësaj faze krasitja përveç sigurimit të prodhimit shoqërohet me krasitjen formuese.

Krasitja prodhuese sipas edhe kuptimit të emërtimit është krasitja që ka si objektiv kryesor sigurimin e një prodhim të qëndrueshëm dhe në ekuilibër me zhvillimin vegjetativ, të sigurojë prodhim të përmirësuar përsa i përket cilësisë dhe të ndihmojë në uljen e periodicitetit.

Në varësi të specieve ndryshon mënyra e frutifikimit dhe kjo kondicionon edhe mënyrën e krasitjes prodhuese. Lulëzimi dhe frutifikimi në disa specie mund të jetë në degët e vjetra (dardha, molla etj), ku edhe prerjet duhen të jenë me masë, ndërsa në speciet që frutifikojnë në lastarët njëvjeçarë, prerjet duhet te jenë më drastike me qëllim sigurimin e prodhimit të qëndrueshëm.

Krasitjet dimërore duhet të kryhen nga fundi i dimrit kur ka kaluar rreziku i ngricave, por para se të çelin sythat, duke eleminuar ditët me reshje dhe me temperata nën zero.

Krasitjet e hershme të pemëve mund të krijojnë probleme, pasi rritet mundesia e prekjes së bimës nga sëmundjet kërpudhore pasi në këtë periudhë bima është në qetësi dhe nuk reagon për mbylljen e plagës, tharja mund të thellohet edhe më shumë se pika e prerjes,

3. Trajtimet dimërore

